

POLIFAKT.al

MAJ/ MAY 2023



600

**DITËT E PARA
TË QEVERISË "RAMA 3"**

NIVELI I PËRMBUSHJES SË
PIKAVE TË PROGRAMIT QEVERISËS
DHE PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE
ZGJEDHORE NË PROGRAM

600 DITËT E PARA TË QEVERISË “RAMA 3” 2021 - 2023

NIVELI I PËRMBUSHJES SË PIKAVE TË PROGRAMIT QEVERISËS DHE
PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE ZGJEDHORE NË PROGRAM

THE FIRST 600 DAYS OF THE "RAMA 3" GOVERNMENT 2021 - 2023

THE LEVEL OF FULFILLMENT OF THE POINTS OF THE GOVERNMENT PROGRAM
AND THE INCLUSION OF ELECTION PROMISES IN THE PROGRAM

PËRGATITJA DHE SHPËRNDARJA



ANALIZË POLITIKO - EKONOMIKE / POLITICAL - ECONOMIC ANALYSIS



Maj/May 2023
TIRANË

**Studime Ekonomike
dhe Fiskale Shqiptare**
SERI TEMATIKE
Nr. 2023/05/06
www.polifakt.al
info@polifakt.al
Datë 10.05.2023
Tiranë, Shqipëri

ALTAX - Qendra Ekonomike dhe Fiskale Shqiptare është një qendër kërkimore dhe zhvilluese jofitimprurëse me bazë në Shqipëri. Ajo analizon politikën ekonomike dhe fiskale të brendshme dhe të jashtme shqiptare për të ofruar një burim të besueshëm ekspertize mbi faktorët politikë, ideologjikë, kulturorë, ekonomikë dhe historikë që ndikojnë në politikat shqiptare ndaj Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. Bashkëpunimi me akademikët dhe ekspertët fiskalë ndihmon në zgjerimin dhe krijimin e një audiencë gjithëpërfshirëse në ndihmë të rritjes së kapaciteteve fiskale në Shqipëri dhe Kosovë.

Ne analizojmë ekonominë, sistemin tatimor, llogaridhënien e politikanëve duke parë kryesisht nivelin kombëtar dhe rajonal të treguesve makro dhe mikro, të dhënat statistikore, tregun, buxhetin e qeverisë, të dhënat e tregut të punës dhe tendencat sektoriale. Edhe pse janë qytetarët ata që përcaktojnë në fund drejtimin e ekonomisë dhe shoqërisë, qeveritë ndikojnë në të edhe nëpërmjet politikës fiskale dhe monetare. Ne ofrojmë për donatorët, organizatat dhe palët e tjera analizën e duhur të temave që janë interesante edhe për parashikimet e ardhshme.

Në Think Tank-un tonë, ne mund të:

- Realizojmë një analizë paraprake mbi politikat ekonomike
- Përgatitim një model të ekspertizave dhe politikave
- Organizojmë studime dhe raporte bazuar mbii partnership me individë dhe organizata
- Përgatitim analizë tregu dhe faktorësh ndikuesë
- Analizojmë të gjitha të dhënat për reflektimin e duhur politik

Informacioni i kontaktit

“600 ditët e para të qeverisë “Rama 3”, 2021 - 2023” gjendet online në <https://altax.al/shop/>

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini tek info@altax.al

ALTAX - Albanian Economic and Fiscal Center is a non-profit research and development center based in Albania. It analyzes Albanian internal and external economic and fiscal policy to provide a reliable source of expertise on the political, ideological, cultural, economic and historical factors influencing Albanian policies towards the Western Balkans and beyond. Cooperation with academics and fiscal experts helps to expand and create a comprehensive audience to help increase fiscal capacities in Albania and Kosovo.

We analyze the economy, the tax system, the accountability of politicians looking mainly at the national and regional level of macro and micro indicators, statistical data, the market, the government budget, labor market data and sectoral trends. Although it is the citizens who ultimately determine the direction of the economy and society, governments also influence it through fiscal and monetary policy. We provide donors, organizations and other parties with the right analysis of topics that are also interesting for future forecasts.

At our Think Tank, we can:

- We carry out a preliminary analysis on economic policies
- Preparation of a model of expertise and policies
- We organize studies and reports based on partnerships with individuals and organizations
- Preparation of market analysis and influencing factors
- We analyze all data for proper political reflection

Contact information

“First 600 days of “Rama 3” Government, 2021 – 2023” is available online at <https://altax.al/shop/>

If you have requests or questions, send them to info@altax.al

KUSHTET E PËRDORIMIT DHE ZBATIMIT

Raporti “600 DITËT E PARA TË QEVERISË “RAMA 3”, 2021 - 2023” është një punim i bazuar në shqyrtimin e zbatimit në praktikën e publikimit të muajit Dhjetor 2022, me matjen e punës së qeverisë Rama 3 për 444 ditë qeverisje. Në hartimin e tij ai është i bazuar duke u krahasuar me raportin e mëparshëm me të njëjtën tematikë të politikave programore kombëtare dhe vendore.

Raporti nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta të secilit aspekt në lidhje me objektivat e zhvillimit, duke paraqitur performancën dhe përbushjen e pikave të programeve sipas sektorëve, për sa i përket niveleve dhe tendencave.

Raporti është një analizë krahasuese me vitin programin e qeverisë “Rama 2” dhe përpara duke tentuar të parashikojë ngjashmëritë dhe ngjarjet më të dukshme në sektorët e jetës dhe ekonomisë shqiptare. Analiza krahasuese është përpunuar nga të dhëna dhe publikime statistikore, institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, nga elaborimet e ekspertëve ekonomikë, si dhe nga investigimet mediatike.

Ky publikim është për qëllime jo fitimprurëse.

Përmbajtja e shprehur në këtë publikim, si dhe fjalët dhe termat nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht QENDRËN ALTAX në rolin e hartuesit, si dhe specifikisht dhe gjithë partnerët e saj që përmbliidhen nën këtë markë të pronësisë intelektuale.

Nëse të dhëna (tekst, grafika apo tabela dhe çdo përmbajtje) nga ky publikim shpërndahen ose riprodhohen, ai duhet të paraqitet me saktësi dhe t'i atribuohet burimit origjinal të përmendur në këtë publikim. Kjo kërkesë për cilësinë e burimit duhet ti bashkangjitet çdo përdorimi të të dhënave dhe komenteve, qoftë të marra direkt nga ALTAX ose nga përdorues tjetër.

Përdoruesit që e bëjnë shkarkimin në dispozicion të të tjerëve përmes çdo lloj shpërndarjeje ose shkarkimi bien dakord të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të komunikuar dhe promovuar pajtueshmërinë nga përdoruesit e tyre përfundimtarë me këto terma.

Përdoruesit që tentojnë të shesin, si një produkt i pavarur i tyre, ose pjesërisht duhet të marrin lejen fillimisht nga qendra ALTAX

Fjalëkyç: #ekonomi #votues #fuqipunetore #inflacion #financa #partipolitike #zgjedhje #qeveri
D10, D30, D60, E20, E40, E60

JEL Code

© Të gjitha të drejtat të rezervuara

Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e Qendrës ALTAX si burim informacioni

TERMS OF USE AND APPLICATION

The report "THE FIRST 600 DAYS OF THE "RAMA 3" GOVERNMENT, 2021 - 2023" is a paper based on the review of the implementation in the practice of publication in December 2022, with the measurement of the work of the Rama 3 government for 444 days of governance. In its drafting, it is based on comparison with the previous report with the same topic of national and local program policies.

The report highlights the strengths and weaknesses of each aspect in relation to the development objectives, presenting the performance and achievement of program targets by sector, in terms of levels and trends.

The report is a comparative analysis with the "Rama 2" government program year and forward, trying to predict the similarities and the most visible events in the sectors of Albanian life and economy. The comparative analysis has been elaborated from data and statistical publications, other national and international institutions, from the elaborations of economic experts, as well as from media investigations.

This publication is for non-profit purposes.

The content expressed in this publication, as well as the words and terms do not necessarily reflect the ALTAX CENTER in the role of the author of the study analysis, as well as specifically and all its partners that are summarized under this brand of intellectual property.

If data (text and any content) from this publication is distributed or reproduced, it must be accurately presented and attributed to the original source cited in this publication. This source quality requirement must accompany any use of data and comments, whether obtained directly from ALTAX or from another user.

Users who make the download available to others through any type of distribution or download agree to use reasonable efforts to communicate and promote compliance by their end users with these terms.

Users attempting to sell, as a stand-alone product of their own, or in part must first obtain permission from the ALTAX Center.

Keywords: #economy #pledges #workforce #inflation #finance #taxes #voters #politicalparty #elections

JEL Code D10, D30, D60, E20, E40, E60

© All rights reserved

The contents of this study may be used freely by users, but not for profit purposes, provided that any such reproduction is accompanied by the acknowledgment of the ALTAX Center as the source of the information.

Konsideratat tona

(ALBANIAN) Raporti studimor dhe përgatitja e kujdesshme në mënyrë të përmbledhur e treguesve të përgatitur në një studim politikash u bë i mundur me mbështetjen e jashtëzakonshme të stafit të ALTAX. Vëmendja e saktë ndaj detajeve kanë qenë një frymëzim dhe e kanë mbajtur punën tonë në rrugën e duhur që nga momenti fillestar dhe deri në momenti kur u përgatit drafti përfundimtar i këtij punimi.

Falënderojmë gjithashtu ekspertët që bashkëpunojnë me POLIFAKT, të cilët dhanë ekspertizë, që ndihmuan shumë në hulumtimin dhe fokusin, megjithëse ata mund të mos pajtohen me të gjitha interpretimet/konkluzionet e këtij punimi.

ALTAX falënderon në mënyrë të veçantë stafin ligjor, si dhe ekspertë të jashtëm për punën e bërë në mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre.

Do të donim gjithashtu të falënderonim dizajnerin për formatimin e bërë këtij publikimi [AA Graphic Designer](#) si dhe për ndihmën në vijimësi që është nevojitur për të zbatuar publikimet tona në aplikacionin ALTAX që mund të shkarkohet në [App Store](#) dhe [Google Play](#).

ALTAX falënderon në mënyrë të dedikuar gjithë ndjekësit dhe lexuesit e publikimeve tona duke na motivuar për një vijimësi të mëtejshme të punës sonë në rolin e një komentatori të financave publike, politikës fiskale, ligjit tatimor, edukimit fiskal, politikave sociale dhe pabarazive sociale në shpërndarjen e mirëqenies duke vlerësuar zhvillimin e politikave me qëllim promovimin e zhvillimit në Shqipëri të krahasuara me vendet në rajon dhe botë.

Për komente dhe sqarime, ju mund të na kontaktoni duke shkruar tek info@polifakt.com

Our acknowledgements

(ENGLISH) The study report and the careful preparation in a concise manner of the indicators prepared in a policy study was made possible with the exceptional support of the ALTAX staff. Their meticulous attention to detail has been an inspiration and kept our work on track from the very beginning until the final draft of this paper was prepared.

We also thank the experts collaborating with POLIFAKT, who provided expertise, who greatly helped with the research and focus, although they may not agree with all the interpretations/conclusions of this paper. ALTAX especially thanks the legal staff, as well as external experts for the work done in data collection, their processing.

We would also like to thank the designer for formatting this edition [AA Graphic Designer](#), as well as the ongoing help needed to implement our publications in the ALTAX app that can be downloaded from the [App Store](#) and [Google Play](#).

ALTAX also dedicatedly thanks all the followers and readers of our publications motivating us for a further continuation of our work in the role of a commentator on public finances, fiscal policy, tax law, fiscal education, social policies and social inequalities in the distribution of well-being by evaluating the development of policies aimed at promoting development in Albania compared to countries in the region and the world.

For comments and clarifications, you can contact us through info@polifakt.com

Ndiqni ALTAX në mediat sociale dhe platformat e aplikacionit tonë:



<https://www.facebook.com/Fiskalisti/>



<https://www.linkedin.com/in/altax/>



<https://twitter.com/EdiGjokutaj>



<https://www.youtube.com/channel/UCvxJEcp5UD9Gn4fformwVqQ>



<https://altax.al>



<https://polifakt.al/>



[App Store](#)

[Google Play](#)

Ne publikojmë dhe shpërndajmë informacione, analiza dhe studime në vijimësi.
Nëse komunikoni përmes adresave të mediave sociale apo nëse shkarkoni Aplikacionin,
JU jeni vendosur në fokusin tonë dhe ne jemi në vëmendjen tuaj duke krijuar së bashku
Një marëdhënie mbi të përbashkëtat që na bashkojnë në jetën e përditshme.

PËRMBAJTJA

	PIKAT KRYESORE	Faqe 11
	METODOLOGJIA DHE TË DHËNAT	Faqe 19
	HYRJE/ INTRODUCTION	Faqe 22
1	Niveli i përmbushjes së programit Ekonomik dhe Fiskal të qeverisë “Rama 3” në 600 ditë	Faqe 26
2	Paraqitja e nivelit të përmbushjes në 600 ditë të programit bujqësor, mjedisor dhe për turizmin i Qeverisë “Rama 3”	Faqe 30
3	Përmbushja e programit të qeverisë “Rama 3” për arsimin, gruan, Rininë, Shëndetësinë, politikat sociale dhe sektoriale	Faqe 37
4	Programi qeverisës “Rama 3” për Infrastrukturën, Energjinë dhe Politikën e jashtme në pamundësi përmbushje	Faqe 50
	SHTOJCA	Faqe 57

SHKURTIME

AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
CEC	Central Election Commission (Komisioni Qendror Zgjedhor)
FZHR	Fondi i Zhvillimi të Rajoneve
FSHZH	Fondi i Zhvillimit Shqiptar
IT	Information Technology – Teknologji Informative
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Para – Aderimit
KE	Këshilli i Europës
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NSH	Ndërmarrje Shtetërore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PD	Partia Demokratike
PBA	Programi Afatmesëm Buxhetor
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
PS	Partia Socialiste
PPP	Partnertiteti Publik - Privat
PPV	Plan i Përgjithshëm Vendor i Territorit
SMFP	Sistemi i Menaxhimit të Financave Publike
TVSH	Tatim mbi Vlerën e Shtuar

PIKAT KRYESORE

Në një krahasim të Programeve qeverisëse dhe Kabineteve në 2017-2021 dhe 2021-2025, duket se Ministrat në shumicën e rasteve janë rrallë anëtarë të fuqishëm të kabinetit. Ky konkluzion është i bazuar te fakti se “nëse shqyrtojmë kompozimin e qeverisë “Rama 2” dhe e krahasojmë me qeverinë Berisha 2, vërejmë të përbashkët konsolidimin e protofoleve të rëndësishme dhe me peshë për arritjen e centralizuar të suksesit për programet në krijimin e ministrive me funksione sa më të zgjeruara në raport me kabinetin paraardhës, të drejtuar nga i njëjti Kryeministër. Edhe në këtë rast, qeveria Rama 2 duket se ka synuar të njëjtën gjë.”¹ (shih te Shtojca të detajuar)

Në studimin e përmbushjes së programit qeverisës ne përballemi me një sfidë konceptuale lidhur me përgjigjen e pyetjes, nëse i ka trajtuar secila qeveri në radhë të gjitha premtimet në mënyrë të barabartë, apo disa premtime për të janë më të rëndësishme se të tjerat? Nëse disa premtime janë më të rëndësishme se të tjerat, si mund ta matim rëndësinë?

Përgjigja në këtë rast nuk është ekonomike.

Në përmbledhjen e premtimeve të bëra nga partitë kryesore politike në fushatën e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, nga matjet e kryera sipas metodologjisë na rezulton një situatë e përmbledhur sektoriale si më poshtë.

Nga 307 premtime gjithsej të tre partive kryesore, vlerësohet se vetëm 24% konsiderohen si të besueshme. Ndërkohë, 27% e premtimeve janë të pamatshme dhe nuk arrin dot të kuptohet realizimi i tyre në praktikë, ndërsa 49% e premtimeve janë konsideruar si pak të besueshme për tu realizuar nga partitë nëse do të arrinin të qeverisnin.

Sipas secilës parti kryesore ju mund ti shikoni më poshtë:

Nga 104 premtime zgjedhore në 2021 të **PS (partia qeverisëse)**, vlerësohen se:

- 32 premtime janë të besueshme se mund të realizohen (31% e premtimeve),
- 47 premtime janë pak të besueshme se mund të realizohen (45% e premtimeve)
- 25 premtime janë të pamatshme dhe nuk mundet dot të përcaktohet realizimi (24% e premtimeve). Me të drejtë, premtimet e pamatshme konsiderohen edhe si firo që në këtë rast është shumë e lartë, për një parti politike bazuar te përgjegjshmëria.

Të detajuara sipas sektorëve këto vlerësime mund ti shikoni më poshtë, apo direkt te [polifakt](#)

– Nga **12 premtime ekonomike** të PS, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 6 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 4 premtime janë ta pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.

¹ <https://polifakt.al/wp-content/uploads/2021/10/Pergjegjshmeria-financiare-e-Programit-qeverises-Rama-3-sipas-premtimeve-elektorale-E.pdf>, faqe 61

- Nga **10 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** të PS, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, 6 premtime janë pak të besueshme. Ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më pak.
- Nga **5 premtime për Bujqësinë** të PS, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, si dhe po 2 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 1 premtim është i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga **7 premtime për Mjedisin dhe Turizmin** të PS, 6 premtime janë të besueshme, 2 premtime pak të besueshme, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **16 premtime për Arsimin, Gruan, Rininë** të PS, 4 premtime vlerësohen si të besueshme, por 10 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 2 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga **2 premtime për Politikën Sociale** të PS, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërkohë 1 premtim konsiderohet i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 5 premtime më pak.
- Nga **10 premtime për Shëndetësinë** të PS, 3 premtime janë të besueshme. Ndërkohë që, 4 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **9 premtime për Kulturën, Digjitalizimin dhe Politikën** të PS, 2 premtime janë të besueshme. Ndërkohë që, 6 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga **9 premtime për Energjinë** të PS, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, 3 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 3 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **21 premtime për Infrastrukturën** të PS, 6 premtime vlerësohen si të besueshme, 10 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Ndërsa 5 premtime vlerësohen si të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 11 premtime më shumë.
- Nga **1 premtim për Politikën e Jashtme** të PS, konsiderohet si i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.

Nga 128 premtime zgjedhore në 2021 të **PD (parti opozitare)**, vlerësohen se:

- 23 premtime janë të besueshme se mund të realizohen (18% e premtimeve),
- 72 premtime janë pak të besueshme se mund të realizohen (56% e premtimeve)
- 33 premtime janë të pamatshme dhe nuk mundet dot të përcaktohet realizimi (26% e premtimeve). Edhe në këtë rast, premtimet e pamatshme janë firo shumë e lartë, për një parti politike bazuar te përgjegjshmëria.

Të detajuara sipas sektorëve këto vlerësime mund ti shikoni më poshtë, apo direkt te [polifakt](#)

- Nga **13 premtime ekonomike** prej PD, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që 7 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 10 premtime më shumë.

- Nga **16 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** prej PD, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 5 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që 10 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga **10 premtime për Bujqësinë** prej PD, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që 5 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **8 premtime për Mjedisin dhe Turizmin** prej PD, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 5 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që 10 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 7 premtime më shumë.
- Nga **18 premtime për Arsimin, Gruan, Rininë** të PD, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, por 10 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 5 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 11 premtime më pak.
- Nga **11 premtime për Politikën Sociale** të PD, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërkohë, 8 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 8 premtime më shumë.
- Nga **9 premtime për Shëndetësinë** të PD, 2 premtime janë të besueshme, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 4 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 8 premtime më shumë.
- Nga **34 premtime për Politikën dhe Administrative** të PD, 9 premtime janë të besueshme, ndërsa 11 premtime konsiderohen si të pamatshëm. Ndërkohë që, 14 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 18 premtime më shumë.
- Nga **3 premtime për Energjinë** të PD, 3 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga **3 premtime për Infrastrukturën** të PD, 3 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga **6 premtime për Politikën e Jashtme** të PD, 4 premtime janë të besueshme, ndërsa 2 premtime konsiderohen si të pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.

Nga 75 premtime zgjedhore në 2021 të LSI (parti që kaloi në opozitë), vlerësohen se:

- 18 premtime janë të besueshme se mund të realizohen (24% e premtimeve),
- 34 premtime janë pak të besueshme se mund të realizohen (45% e premtimeve)
- 23 premtime janë të pamatshme dhe nuk mundet dot të përcaktohet realizimi (31% e premtimeve). Në këtë rast, premtimet e pamatshme janë me firo edhe më të lartë, se rastet e premtimeve të pamatshme të dy partive politike më të mëdha.

Të detajuara sipas sektorëve këto vlerësime mund ti shikoni më poshtë, apo direkt te [polifakt](#)

- Nga **13 premtime ekonomike** të LSI, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, 4 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 7 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga **13 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** të LSI, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 7 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 5 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se janë në të njëjtat numra.
- Nga **7 premtime për Bujqësinë** të LSI, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 2 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga **2 premtime për Mjedisin dhe Turizmin** të LSI, 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë, 1 premtim vlerësohet pak i besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 2 premtime më pak.
- Nga **18 premtime për Arsimin, Gruan, Rininë** të LSI, 4 premtime vlerësohen si të besueshme, 9 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 5 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 16 premtime më shumë.
- Nga **4 premtime për Politikën Sociale** të LSI, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërkohë 2 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **3 premtime për Shëndetësinë** të LSI, 3 premtime janë të besueshme, ndërsa 2 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 2 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga **5 premtime për Administrimin dhe Politikën** të LSI, 1 premtim është i besueshëm, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që, 6 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga **2 premtime për Energjinë** të LSI, të 2 premtimet vlerësohen si të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga **1 premtim për Infrastruktura** të LSI, ai vlerësohet si i besueshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 nuk ka ndryshim.
- Nga **1 premtim për Politikën e Jashtme** të LSI, 1 premtim është i besueshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.

Por, mbetet mjaft i vërtetë niveli i konstatuar i mungesës së përgjegjshmërisë, në rastin kur konstatojmë nga matjet e kryera se sa është realisht niveli i përmbushjes së qeverisë për 600 ditët e para, bazuar te premtimet e partisë socialiste, në 2021


Programi qeverisës 2017 – 2021, apo qeveria “Rama 2” arriti ta realizojë programin qeverisës deri në nivelin 52%, ndërkohë 48% të programit nuk arriti të përmbushet.

Në matjen e përmbushjes së programit sipas sektorëve për 444 ditë, shihet se Qeveria “Rama 3” sipas Programit Qeverisës 2021 – 2025 paraqitet si më poshtë:

- Vlerësohen me statusin “Përbushur” 13 programe (3 programe më shumë se 144 ditë përpara) dhe me peshë sa 16% e programit qeverisës apo 3% më shumë se 300 ditëshi;
- Vlerësohen me statusin “Në progres” apo ka filluar përgatitja për 54 programe (nuk ka ndryshim me 144 ditë përpara), me peshë sa 68% e programit qeverisës;
- Vlerësohen me statusin “Pa përbushur” apo nuk arrijnë të përbushen (për shkak të mbarimit të afatit) ose nuk ka asnjë info për fillimin e masave për 12 programe (3 programe më pak se 144 ditë më përpara), me peshë sa 16% e programit qeverisës apo 4% më pak se 300 ditëshi.

Niveli i performancës në 444 ditët e para të qeverisë “Rama 3” kur krahasohet me nivelin e performancës në 300 ditët e para ka një ndryshim pozitiv me 3% më shumë programe të përbushura dhe 3% më pak programe të papërbushura.

Ndërkohë, kur më 11 Maj 2023 mbushen 600 ditët e para, shihet se vetëm 19% e programit konsiderohet i përbushur. Ky është një përmirësim me 6% më shumë se 300 ditët e para. Niveli 62% i programit shihet se është në progres përbushje deri në vitin 2025. Edhe ky nivel përbushje është ulur me 6% krahasuar me 300 ditët e para. Mbetet 19% e programit të mos jetë përbushur, pasi kanë kaluar afatet e programuara, apo ende nuk ka asnjë informacion mbi zhvillimin e programit. Ky nivel mospërbushje është më lart se 300 ditët e para, pasi një pjese të programit tashmë i kanë kaluar afatet e përcaktuara në programin qeverisës. Grafiku më poshtë bashkë me sqarimet pasqyrojnë në detaje nivelet e përbushjes sipas ministrive.



Në analizën e detajuar të **përmbushjes së programit të qeverisë** “Rama 3” dhe krahasuar me studimin e afër dy vite qeverisje, ekspertët e POLIFAKT vërejnë se situata e performancës së programit sipas ministrive është si vijon:

– **Për Ekonominë** nga 12 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 7 pika në programin qeverisës (ku një **pikë e re në program** është shtuar). Nga këto pika të përzgjedhura është përmbushur 1 pikë programore (14% e programit ekonomik). Janë përmbushur pjesërisht duke qenë drejt progresit të përmbushjes 4 pika të programit (57% e programit ekonomik). Ndërkohë nuk janë përmbushur 2 pika programore (29% e programit ekonomik). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se 4 pikat e papërmbushura të këtij programi ekonomik është mbartur vetëm një pikë dhe 3 pikat e tjera nuk janë mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Politikat Fiskale** nga 10 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 7 pika në programin qeverisës. Është përmbushur 1 pikë programore (14% e programit fiskal). Janë përmbushur pjesërisht 5 pika programi qeverisës (71% e programit fiskal). Nuk është përmbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi 1 pikë e programit (15% e programit fiskal). **Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 5 pikat e pa përmbushura të këtij programi fiskal nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3” asnjë pikë.**

– **Për Bujqësinë** nga 5 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 8 pika në programin qeverisës (ku tre pika janë të reja në program është shtuar). Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 2 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë përmbushur 5 pika programore (63% e programit për bujqësinë). Ndërkohë nuk janë përmbushur 3 pika programore (37% e programit ekonomik). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 3 pikat e papërmbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Mjedisin dhe Turizmin** nga 7 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 2 pika në programin qeverisës. Ndërsa, 4 pikat e tjera të programit qeverisës janë pika të reja të papërmendura gjatë fushatës së vitit 2021.

Nga programi për mjedisin dhe turizmin është përmbushur 1 pikë programore (17% e programit për mjedisin dhe turizmin). Janë përmbushur pjesërisht 4 pika programi qeverisës (66% e programit fiskal). Nuk është përmbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi 1 pikë e programit (17% e programit fiskal). **Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se 1 pikë e papërmbushur e këtij programi nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Arsimin, Gruan, Rininë** nga 16 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 8 pika në programin qeverisës (ku 4 pika janë të reja në program është shtuar). Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 12 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë përmbushur 3 pika programore (38% e programit për arsimin). Ndërkohë janë në progres përmbushje 5 pika programore (62% e programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 8 pikat e papërmbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Politikat Sociale** nga 2 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë të 2 pikat në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 9 pika janë të reja në programin social. Nga pikat e programit është përbushur 1 pikë programore (9% e programit social). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 8 pika programi (73% e programit social). Nuk janë përbushur 2 pika programore (18% të programit social). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 3 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Shëndetësinë** nga 10 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 5 pika në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 4 pika janë të reja në programin social. Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 5 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit është përbushur 1 pikë programore (11% e programit për shëndetësinë). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 7 pika programi (78% e programit). Nuk është përbushur ende 1 pikë programore (11% të programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 1 pikë e papërbushur e këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Energjinë** nga 9 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 3 pika në programin qeverisës dhe dy programe të reja nuk janë pjesë e premtimeve të përmendura gjatë fushatës zgjedhore. Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 6 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë në progres përbushje 4 pika programore (80% e programit) dhe nuk është përbushur ende 1 pikë programore (20% të programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 4 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur vetëm një prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Infrastrukturën** nga 21 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 6 pika në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 2 pika janë të reja në programin social. Nga pikat e programit janë përbushur 2 pika programore (25% e programit). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 3 pika programi (37% e programit social). Nuk janë përbushur 3 pika programore (38% të programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 7 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

- **Për Kulturën, Digjitalizimin dhe Politikat** nga 9 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 4 pika në programin qeverisës. Ndërsa, 5 premtimet e tjera nuk u përfshinë në programin qeverisës. Janë shtuar 6 pika të reja të papërmendura gjatë fushatës së vitit 2021 ashtu si paraqiten në program.

Nga programi për kulturën dhe digjitalizimin janë përbushur 2 pikë programore (20% e programit). Janë përbushur pjesërisht 6 pika programi qeverisës (60% e programit fiskal). Nuk ka pika të papërbushura.

Nga programi për politikat në drejtësi dhe pronë është në progres për tu përbushur 1 pikë programore (10% e programit). Nuk është përbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi për 1 pikë e programit (10% e programit).

Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 2 pika te papërbushura te këtyre programeve nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.

- **Për Politikën e Jashtme** nga 1 premtim në fushatën zgjedhore është përfshirë si pikë në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 2 pika janë të reja në programin e politikës së jashtme. Nga pikat e programit nuk është përmbushur asnjë pikë programore. Janë në progres përmbushje apo priten të përmbushen deri në 3 pika programi (100% e programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga nuk ka patur asnjë pikë të papërmbushur te këtij programi për tu mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.**

Në kapitujt më poshtë gjenden për secilën pikë të programit, si dhe për secilën pikë të papërmbushur nga programi qeverisës “Rama 2”

Metodologjia

1. Qasja dhe qëllimi i përdorimit të metodologjisë

Kjo metodë e hulumtimit kryesisht është bazuar te faktori i krahasimit dhe përdoret në këtë studim analitik për të përfunduar ekuacionin shkak-pasojë midis dy ose më shumë të dhënave (premtime/ program/ përmbushje) për partitë politike përpara, gjatë dhe pas fushatës elektorale, ku një e dhënë është e varur nga e dhëna tjetër, por jo detyrimisht. Në vijim të kësaj logjike në studim është parashtruar në lioni horizontale dhe vijueshmëria historike e premtimit dhe më tej përfshirjes së tij në program ose jo dhe niveli i përmbushjes. Kjo ndjekje në linjë historike që nga gjeneza e premtimit dhe deri te zbatimi it ij është edhe baza e matjes së përgjegjshmërisë së një zotimi politik.

Në analizën që trajtohet nga kjo metodologji do të përdoren premtimet e Partisë Socialiste (PS) në fushatën e zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021, si dhe Programi Qeverisës 2021 -2025 i shpallur nga kjo parti në Kuvendin e Shqipërisë më 16 Shtator 2021, me statusin e fituesit të zgjedhjeve 2021 dhe marrjes së mandatit për të krijuar kabinetin qeveritar për 4-vitet e ardhme.

Në analizimin e të dhënave janë përdorur baza krahasimi në drejtimin e një qasje bazuar në aspektet ligjore, aspekte strategjike, programe në nivel kombëtar ekonomike dhe sektoriale, por pa patur domosdoshmërisht krahasim statistikor. Baza tjetër e krahasimit është përballja e premtimeve që lidhen me prekjen e parashikimeve të buxhetit në vlerën e përlloritur (ose ashtu si është thënë nga drejtuesit politikë të partive) dhe pas përfshirjes së tyre në program llogariten kostot e reduktuara/shtuara, në varësi të numrit të përfshirjes së premtimeve zgjedhore 2021. Këto të dhëna ose grupe të dhënash janë përdorur ashtu siç ekzistojnë në strukturën e tyre natyrale në burimet e të dhënave.

Analiza nuk është kufizuar në trajtime të fakteve statistikore të grupeve të të dhënave, por shtrihet në studimin se si ndryshojnë ato ose grupet e ndryshme nën ndikimin e të njëjtave ndryshime. Analiza e të dhënave bazuar te strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale përdoret për të paraqitur qartë rezultatin e marrë duke përdorur këtë metodë sasiore të hulumtimit, duke u nisur nga fakti se dokumentet strategjike të një vendi marrin rëndësi të dorës së parë përtej qeverisë që e miraton, për vetë kohëzgjatjen dhe misionin që përmbajnë ato.

Në mjaft raste, kur janë analizuar përmbushja e programit qeverisës 2017-2021 (programi i kaluar i qeverisë “Rama 2”), apo edhe në rastet e referimit të përfshirjes së premtimeve në 2021 në programin qeverisës 2021-2025 janë përdorur referenca për të provuar vlerësimin e bërë për nivelin e përmbushjes. Por, për qëllim të mospërsëritjes së të njëjtit burim ne kemi nënkuptuar që nëse burimi për të njëjtën tematikë programi sektoriale është i njëjtë, ai vlen edhe për pikat e tjera në po atë sektor.

2. Metodatat kryesore e të dhënave

Metoda kryesore e marrjes së të dhënave për analizën është bërë bazuar te të dhënat kërkimore sekondare. Kjo metodë përfshin mbledhjen e të dhënave sasiore nga burimet ekzistuese të të dhënave si interneti, burimet qeveritare, raportet studimore, burimet kërkimore, statistikore, mediatike, etj. Hartimi dhe renditja e premtimeve te grumbulluara janë të përcjella me kujdes duke u bazuar te fjalimet kryesore dhe prezantimet e drejtuesve kryesorë të partive politike përgjatë gjithë fillimit të vitit 2021.

Studimi ka përfshirë shumicën e premtimeve kryesore dhe jo kryesore duke synuar që të paraqiten të gjitha citimet dhe premtimet e dhëna nga liderët kryesorë të partive.

3. Metoda e analizës së të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave të papërpunuara është kaluar në realizimin e filtrimit dhe më tej të analizës së këtyre të dhënave për të nxjerrë përfundime vlerësuese. Është e rëndësishme të përmendim se në këtë studim janë lidhur rezultatet me objektivin e hulumtimit duke përcaktuar edhe rëndësinë statistikore të rezultateve.

Është e rëndësishme gjithashtu të përmendim se në studim kemi marrë parasysh ato aspekte të hulumtimit, të cilat u morën në konsideratë në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe janë raportuar në këtë studim me ndryshimin midis asaj që ishte planifikuar kundrejt asaj që ka rezultuar në të vërtetë.

Me metodën e analizës statistikore midis grupeve të të dhënave është vijuar më tej duke krahasuar në çdo premtim me peshë ndikuese, për secilin sektor publik që merr fonde nga buxheti i shtetit apo ndikon në jetën e qytetarëve dhe bizneseve (ndryshimet ligjore). Bazuar te krahasimet e premtimeve të fushatës zgjedhore me Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) dhe Buxhetet vjetore është krijuar një seri të dhënash krahasuese, ku premtimi nga njëra anë (sipas ndarjes sektoriale) krahasohet me vlerën e përfshirë (ose jo) në PBA për periudhën në të cilën referohet premtimi duke theksuar edhe diferencën që rezultojnë midis vlerës së llogaritur të premtimit dhe hapësirës së buxhetit për shpenzim.

P.sh. nëse është premtuar që do të rriten rrogat e mësuesve, infermierëve dhe mjekëve nga viti 2022 me 40%, atëherë do të bëhet llogaritja se sa i kushton buxhetit vjetor kjo pikë e programit qeverisës në vlerë absolute. Më tej rezultati vleror krahasohet me parashikimin që gjendet në PBA 2021-2023, për të krahasuar vlerën e premtimit me vlerën që përcaktohet për këtë zë në sektorin e arsimit.

4. Burimi i të dhënave

Të dhënat e disponueshme në internet janë ato që janë shfrytëzuar gjerësisht duke cituar në çdo rast të përmendur si burim informacioni edhe linkun nga është marrë e dhëna/informacioni.

Me informacionin e bollshëm në faqet e ndryshme informative dhe statistikore është synuar që të përzgjidhen edhe burime të besueshme informative, pasi informacioni në lidhje me shumicën e temave të hulumtimit edhe pse është i disponueshëm mundet të ketë gabime apo pasaktësi. Kjo analizë kryqëzuese na ka ndihmuar në rritjen e vlefshmërisë së të dhënave kryesore sasiore dhe cilësore, si dhe në vlerësimin e rëndësisë së të dhënave të mbledhura.

Burimet qeveritare dhe joqeveritare të informimit janë përdorur gjithashtu lidhur me premtimet qeverisëse, por edhe të dhënat për Programin Buxhetor Afatmesëm, si dhe të dhëna të tjera statistikore dhe financiare, që janë grumbulluar si informacion i gatshëm për tu përdorur për analizën studimore të bazuar te krahasimi. Këto të dhëna janë konsideruar prej nesh si të besueshme dhe të thelluara duke i përdorur për të rritur vlefshmërinë e përmbajtjes të të dhënave kërkimore të studimit.

Informacione publike të marra nga mediat kryesore janë një burim i përdorur me masë në kryerjen e kërkimit, për arsye se mediat e referuara janë ende në tregun mediatik një burim i besueshëm

informacioni. Nisur nga fakti se mediat e shkruara kanë kopje të rëndësishme të të dhënave për premtimet që janë deklaruar janë analizuar dhe vlerësuar edhe këto informacione që përbëjnë një pjesë të përzgjedhjes së premtimeve 2021.

Ato janë një bazë me informacione dhe dokumente të vlefshme nga të cilat janë nxjerrë informacione, që kanë plotësuar ato që nuk mundeshin të gjendeshin me dy burimet si më lart.

5. Sqarimi i shmangieve dhe parregullsive

Nga analiza dalin edhe disa gjetje, se sa ndikojnë premtimet e partive në programet qeverisëse, si dhe devijimet që mund të ndodhin edhe nga vetë programet fillestare qeverisëse duke i krahasuar me programet buxhetore që janë zbatuar mbi 10 vitet e fundit. Një gjetje tjetër rezulton nga analiza e fakteve, se cila forcë politike e ka patur realizimin bazuar te premtimet e veta.

Shmangiet dhe gabimet janë pjesë e mundshme e analizës. Por, në llogaritjet e kryera kjo shmangie nuk arrin të abstrahojë nga rrjedha e të dhënave bazë të buxhetit. Në gjithë llogaritjet e kryera është përdorur rrumbullakosja e vlerave.

Ne jemi të hapur të pranojmë komente dhe llogaritje, kur kanë burime dhe referenca të sakta duke na i komentuar direkt te secili nga pikat e premtimit apo programit qeverisës te www.polifakt.al.

Ne do të pasqyrojmë gabimin e korrigjuar duke vendosur edhe burimin e tij.

HYRJE

Partia Socialiste i fitoi zgjedhjet e 25 Prillit 2021, sipas shpalljes së rezultatit zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (KQZ) me 48.7 përqind të votave, që përkthehet në 74 mandate deputetësh në Parlamentin prej 140 vendesh. Kundërshtarja e saj, Partia Demokratike fitoi 39.5 përqind të votave, që përbëjnë 59 mandate, Lëvizja Socialiste për Integrim fitoi 6.8% të votave (4 mandate) dhe Partia Social-Demokrate fitoi 3 mandate. Partitë e reja nuk e kapën pragun për të patur përfaqësuesit e tyre në Parlament.

Këto zgjedhje u dalluan nga pjesëmarrje e ulët e votuesve duke regjistruar pjesëmarrjen më të ulët në historinë e zgjedhjeve në Shqipëri të historisë pluraliste. Nga 3.45 milionë shqiptarë me të drejtë vote, 1.57 milionë ose 46.3 për qind e ushtruan të drejtën e tyre të votës. Në krahasim me zgjedhjet e vitit 2013 u hodhën më pak rreth 160 mijë vota. Ndërkohë, lista e votuesve gjatë 4-vjeçarit është shtuar me 180 mijë votues të rinj. Të gjitha qarqet e vendit kanë pësuar rënie në pjesëmarrje në krahasim me vitin 2013. Sipas të dhënave të raportuara nga KQZ, Qarku i Vlorës regjistroi pjesëmarrjen më të ulët në rang kombëtar me 34.05 për qind, i pasuar nga Qarku Shkodër me 41.8 për qind. Qarku i Tiranës rezultoi me pjesëmarrjen më të lartë me 54.32 përqind. Qarku i Dibrës rezultoi po kështu me pjesëmarrje të lartë me 52.95 për qind dhe Qarku i Kukësit me 48.47 për qind. Qarqet me rënien më të thellë janë Kukësi dhe Tirana me nga 9.2 për qind, pasuar nga Fieri me 8.3 për qind.

Ndikuesit e përmbushjes së premtimeve të fushatës në Shqipëri përgjatë 2021 janë analizuar në një perspektivë krahasuese. Premtimet e bëra në muajin e fushatës zyrtare, ku disa prej të cilave ishin deklaruar edhe pak më herët se të fillonte kjo fushatë përfshijnë të gjithë sektorët qeverisës të kaluar dhe ato që tashmë janë rikonfirmuar si fusha drejtimi ministeriale. Ndër premtimet më të spikatura veçojmë (a) premtimet e përsëritura, (b) premtime të reja.

Programi Politik i Qeverisë në disa sektorë është më i qartë dhe i matshëm (arsimi, infrastruktura, energjia, politikat sociale, rindërtimi, lufta ndaj pandemisë Covid-19). Në sektorë të tjerë (shëndetësia, turizmi, bujqësia, fiskale dhe buxhetore, infrastruktura e ujësjellës-kanalizime, mjedisi, industria minerare dhe ushqimore, ekonomia publike, punësimi) pikat e programit janë jo të qarta, konkrete dhe të matshme.

Programi qeverisës, nuk i ka përfshirë më shumë se 46% të premtimeve specifike të deklaruara nga lidërshipi kryesor i PS-së gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 Prillit 2021. Premtimet e pa përfshira në program janë pjesë e punës rutinë dhe projekte buxhetore në proces planifikimi/zbatimi. Këto premtime janë zëvendësuar me pika programi të reja, të cilat janë projekte buxhetore/ligjore në etapa ecurie të ndryshme sipas linjave ministrore të kabinetit qeveritar "Rama 2". Nga ky këndvështrim i pozicionimit të programit qeverisës, duket se hartuesit e tij kanë hequr pjesët e detajuara në premtimet për infrastrukturën dhe transportin, për arsimin, për shëndetësinë, për ekonominë, për kulturën, për bujqësinë, si dhe për energjinë për ti zëvendësuar me të reja, por që në shumicën e tyre e përfshijnë logjikën e premtimit, si dhe kanë një orientim më elektoral.

Në një krahasim të Programeve qeverisëse dhe Kabineteve në 2017-2021 dhe 2021-2025, duket se Ministrat në shumicën e rasteve janë rrallë anëtarë të fuqishëm të kabinetit. Ndërkohë, në procesin e vendimmarrjes dhe hartimin e programeve nuk përfshihen shumë aktorë nga grupe të ndryshme sociale dhe grupe interesi. Publikut të gjerë i jepet për të dialoguar me përfaqësuesit e qeverisë politika/masa të diktuar nga qeveria, pa konsultime të thelluara.

Nisur nga kjo qasje është ndikuar pjesërisht edhe performanca e realizimit të programeve qeverisëse. Analiza na tregon, se detyrat e qeverisë nuk kanë shkuar më mirë, pasi kjo përvoje në realitet arrin të krijojë dublim dhe kosto të dëmshme financiare dhe etike. Në përgjithësi, programet e mirëqenies dhe infrastrukturës kanë tërheqje shumë më të madhe buxhetore sesa programet e tjera dhe këtë e kemi vërejtur në të gjitha qeveritë e kaluara dhe programin e qeverisë “Rama 3”.

Arsyeja kryesore është se ato përfshijnë përfitime politike të prekshme pasi shpenzimet në projekte të përqëndruara kanë shanse të kenë edhe suksesin e garantuar për të krijuar kapital politik. Kjo mënyrë, që vihet re veçanërisht, kur mandatet përsëriten.

Programet në qeverisjet në vijimësi prodhojnë grupe të fuqishme interesi për të mbrojtur dhe zgjeruar përfitimet politike, por edhe orientimin e votuesit klientelist. Për më tepër, qeveritë kanë gjetur se zgjidhja e disa problemeve që adresohen për shtresat në nevojë dhe ato të marginalizuara mund të shmangë nevojën për një numër të madh ankesash nga votuesit.

Nga angazhimet më të mëdha financiare që Socialistët kanë marrë gjatë fushatës zgjedhore janë fatura e rindërtimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019, faturat e infrastrukturës, si dhe rritja e pagave për mësuesit, mjekët dhe infermierët të cilat minimalisht e rritin presionin fiskal ndaj buxhetit të shtetit me të paktën 2% të PBB-së. Të tre këto grup shpenzimesh përbëjnë 80.9% të totalit të shpenzimeve shtesë, si pasojë e aktivizimit të programit qeverisës “Rama 3”, në mbajtje të premtimeve të fushatës zgjedhore gjatë fillimvitit 2021.

Ndikimi i buxhetit nga programi qeverisës “Rama 3”, bazuar te premtimet zgjedhore në tërësinë e tij, i shton shpenzimeve të buxhetit një faturë vjetore prej 65.7 miliardë lekë dhe me një efekt në të hyrat e buxhetit me 4.8 miliardë lekë. Nisur nga llogaritja midis tyre, ndikimi në buxhet është me efekt negativ prej 60.9 miliardë lekësh.

Në tërësinë e programit të qeverisë “Rama 2”, në lidhje me shpenzimet shtesë sipas premtimeve elektorale, llogaritet një kosto buxhetore që ka ndikuar në një barrë në buxhetin e shtetit vit për vit sa 0.8% të PBB-së. Ndikimin më të madh në këtë rritje të koston buxhetore e kanë patur shpenzimet për infrastrukturën rrugore, shpenzimet për projektet për edukimin, për pagat e administratës dhe pensionet, shpenzimet për ujësjellës-kanalizimet dhe infrastrukturën e mbetjeve me një ndikim te borxhi sa 0.6% e PBB-së.

Në kushtet, kur treguesi mesatar i rritjes ekonomike në 4 vitet e fundit (pa përfshirë 2020) është 3.3%, atëherë objektivi prej 4.5% për periudhën 2021 -2025 është i arritshëm nëse do të plotësohen gjithë premtimet për investimet në infrastrukturën aeroportuale, infrastrukturën rrugore, turistike dhe investimet në sektorët e dedikuar të ekonomisë.

Ky target do të ishte i besueshëm, nëse reformat e stopuara, si dhe reforma të nisura në qeverinë “Rama 2” do të fillojnë të jetësoheshin që në vitin e parë të qeverisë, duke patur një plan veprimi të plotë dhe të qartë bashkë me buxhetin e bazuar te vlera e drejtë dhe transparente për votuesit.

Duket se sfidat e pazgjidhura nga qeveria “Rama 2” kanë patur nevojë të akomodoheshin në detyrat e reja të ministrive, që filluan nga puna 600 ditë më parë.

Në këtë kontekst, si një obligim parësor nevojitet që secila qeveri t të bëjë edhe analiza fiskale transparente dhe analiza mbi kosto-përfitimin e politikave dhe ligjeve mjaft të rëndësishëm për ekonominë dhe jetën e vendit, si p.sh. ligji mbi investimet strategjike në 2015, i cili zbatohet ngushtësisht i lidhur me akte të tjerfra ligjore për thithjen e investimeve të huaja, zonat ekonomike dhe zhvillimin e strategjive kombëtare për sektorët më kryesorë.

INTRODUCTION

The Socialist Party won the elections of April 25, 2021, according to the announcement of the election results by the Central Election Commission, (CEC) with 48.7 percent of the votes, which translates into 74 mandates of deputies in the Parliament of 140 countries. Its opponent, the Democratic Party won 39.5 percent of the votes, which constitute 59 mandates, the Socialist Integration Movement won 6.8% of the votes (4 mandates) and the Social-Democratic Party won 3 mandates. The new parties did not reach the threshold to have their representatives in the Parliament.

These elections were distinguished by low voter turnout, registering the lowest turnout in the history of elections in Albania's pluralist history. Of the 3.45 million Albanians with the right to vote, 1.57 million or 46.3 percent exercised their right to vote. Compared to the 2013 elections, about 160,000 fewer votes were cast. Meanwhile, the list of voters during the 4-year period has been increased by 180,000 new voters. All districts of the country have suffered a decrease in participation compared to 2013. According to the data reported by the CEC, Vlora District recorded the lowest participation at the national level with 34.05 percent, followed by Shkodër District with 41.8 percent. The district of Tirana resulted in the highest participation with 54.32 percent. The District of Dibra also showed high participation with 52.95 percent and the District of Kukës with 48.47 percent. The districts with the deepest decline are Kukësi and Tirana with 9.2 percent each, followed by Fieri with 8.3 percent.

The impacts of meeting campaign promise in Albania throughout 2021 have been analyzed in a comparative perspective. The promises made in the month of the official campaign, some of which were declared even shortly before the start of this campaign, include all the previous governing sectors and those that have already been reconfirmed as areas of ministerial leadership. Among the most prominent promises we single out (a) repeated promises, (b) new promises.

The Government Policy Program in some sectors is clearer and more measurable (education, infrastructure, energy, social policies, reconstruction, fight against the Covid-19 pandemic). In other sectors (health, tourism, agriculture, fiscal and budgetary, water supply and sewerage infrastructure, environment, mining and food industry, public economy, employment) the points of the program are unclear, and not measurable.

The government program does not include more than 46% of the specific promises made by the main SP leadership during the election campaign for the elections of April 25, 2021. The promises not included in the program are part of routine work and ongoing budget projects. These promises have been replaced by new program items, which are budget / legal projects in different stages according to the ministerial lines of the government cabinet "Rama 2".

From this point of view of the positioning of the government program, it seems that the drafters removed the most detailed parts, in the promises for infrastructure and transport, for education, for health, for the economy, for culture, for agriculture, as well as for energy to replace them with new ones, but which in most of them include the logic of the promise, because they have an orientation more electoral than budgetary one.

In a comparison of Government Programs and Cabinets in 2017-2021 and 2021-2025, it appears that Ministers in most cases are rarely powerful members of the Cabinet. Meanwhile, many actors from different social groups and interest groups are not involved in the decision-making process and program design.

The general public is given the opportunity to dialogue with government representatives on policies / measures dictated by the government, without in-depth consultations. Based on this approach, the performance of the implementation of government programs has been partially affected. The analysis shows that the government's tasks have not gone better, as this experience in reality manages to create duplication and harmful financial and ethical costs.

In general, welfare and infrastructure programs have much greater budgetary allocations than other programs and we have seen this in all previous governments and the "Rama 3" government program. The main reason is that they include tangible political benefits as spending on Concentrated projects have the guaranteed success of creating political capital. This way is especially noticeable when the mandates are repeated.

Ongoing government programs produce strong interest groups to protect and expand political benefits, but also clientelist voter orientation. Moreover, governments have explored that solving some of the problems addressed to the needy and marginalized can avoid the costs for a large number of complaints from voters.

Among the biggest financial commitments that the Socialists have made during the election campaign are the bills for the recovery of the damages caused by the earthquake of November 2019, the infrastructure bills, as well as the salary increase for teachers, doctors and nurses, that minimally increased the fiscal pressure on state budget with at least 2% of GDP.

All three of these expenditure groups accounts for 80.9% of the total additional expenditures, if the activation of the "Rama 3" government program, in keeping with the promises of the election campaign during the beginning of 2021. The impact of the budget from the "Rama 3" governing program, based on the election promises in its entirety, adds to the budget expenditures an annual bill of ALL 65.7 billion and an effect on budget revenues of ALL 4.8 billion. Based on the calculation between them, the impact on the budget has a negative effect of ALL 60.9 billion.

When we calculate the costs of the "Rama 2" government program, in relation to additional expenditures according to electoral promises, a budget cost is calculated that has affected with a fiscal burden on the state budget year by year as much as 0.8% of GDP. The biggest impact on this increase in budget costs have been expenditures on road infrastructure, expenditures on education projects, administration salaries and pensions, expenditures on water supply and sewerage and waste infrastructure with a debt impact of 0.6% of GDP. In the conditions, when the average economic growth indicator in the last 4 years (excluding 2020) is 3.3%, then the target of 4.5% for the period 2021-2025 is achievable if all the promises for investments in airports and harbors, in roads, in agrotourism and investments in tourism infrastructure and investment in dedicated sectors of the economy are met.

This target is credible, if the stopped reforms, as well as the ongoing reforms started in the "Rama 2" government would have been implemented in the first year of the government "Rama 3", having a complete and clear action plan together with the fair and transparent value budgeting.

We think that the unresolved challenges by the "Rama 2" government they needed it to be accommodated in the new tasks of the ministries, which started working 600 days ago.

In this context, as a primary obligation it is necessary for government to do transparent fiscal analysis and cost-benefit analysis of policies of very important laws for the economy and life of the country, such as for instance the law on strategic investments in 2015, which acts closely in relation with the other legal acts about absorption of foreign investment, economic zones and the development of national strategies for key sectors.

1. Niveli i përmbushjes së programit Ekonomik dhe Fiskal të qeverisë “Rama 3” në 600 ditë

Nisur nga momenti kur duhen pak ditë dhe Qeveria “Rama 3” mbyll një tjetër fazë të qeverisjes, POLIFAKT në këto dy javët e fundit për të krijuar një historik të zotimeve dhe përmbushjeve të liderëve të partive kryesore ka publikuar premtimet e tyre të zgjedhjeve qendrore të vitit 2009, të vitit 2013, të vitit 2017. Ndërkohë, pasi u analizua niveli i besueshmërisë së premtimeve të këtyre zgjedhjeve, angazhimi vijoi në studimin e përfshirjes së tyre në programet e tre qeverive të fundit (Berisha 2, Rama 1, Rama 2). Pas kësaj u krahasuan programet me veprimet e qeverisjes nëpërmjet fakteve ligjore, mediatike dhe financiare.

Nisur nga gjithë baza e të dhënave për premtimet analitike, kostot e tyre, programet qeverisëse dhe analiza e përmbushjeve të tyre, ju mund të lexoni online te POLIFAKT të gjitha këto. Gjithë kjo përpjekje vjen me qëllimin e rikthimit të vëmendjes te zotimet për të besuar në përmbushjen e tyre. Kushdo që lexoi dhe ata që kanë monitoruar direkt vetë apo e kanë kujtesën e fortë tashmë duhet të mbajë mend edhe sa ishte niveli i përmbushjes së premtimeve zgjedhore pas krijimit të qeverisë “Rama 2” (vetëm PS) dhe miratimit të **Programit qeverisës 2021 -2025**.

Në studimin e **premtimeve të partive kryesore**, kur shikojmë **besueshmërinë e premtimeve zgjedhore të vitit 2021**, sipas matjes së bërë nga POLIFAKT rezulton se:

- Nga **12 premtime ekonomike** të PS, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 6 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 4 premtime janë ta pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga **10 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** të PS, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që 6 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më pak.
- Nga **13 premtime ekonomike** prej PD, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që 7 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 10 premtime më shumë.
- Nga **16 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** prej PD, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 5 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që 10 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.

- Nga **13 premtime ekonomik** të LSI, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, 4 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 7 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga **13 premtime të politikës fiskale dhe buxhetore** të LSI, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 7 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 5 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se janë në të njëjtat numra.

Më poshtë janë paraqitur premtimet ekonomike dhe fiskale në fushatën e vitit 2021 të partisë socialiste (kolona e parë). Kolona e dytë janë pikat e programit, që vijnë nga përfshirja e premtimeve sipas kolonës së parë. Në kolonën e tretë prezantohen pikat e programit të papërbushura nga qeveria “Rama 2” për ti krahasuar me pikat e reja të programit të ri qeverisës, si dhe për të analizuar nëse ka vijueshmëri, meqenëse kanë rezultuar të pakryera gjatë mandatit 2017-2021. Në kolonën e katërt janë paraqitur nivelet e realizimit të pikave të programit aktual qeverisës deri në fund të 600 ditëve të para të qeverisë.

2021 -2025 – QEVERIA RAMA 3 (PS)

EKONOMIA

<u>PREMTIMET E PS 2021</u>	<u>PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE NGA QEVERIA “RAMA 3”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 2”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 3”</u>
	<u>Rrisim të ardhurat e disponueshme me 20% deri në fund të mandatit</u>	<u>PIKË E RE</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>
<u>Kritja e pagës minimale vit pas viti deri në 40 mijë lekë në fund të mandatit</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>		<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Kalimi i gjithë sistemit të manufakturës, që njihet si fason, në një nivel tjetër, duke synuar prodhimtarinë me cikël të mbyllur “Made in Albania”</u>	<u>Mbështesim sipërmarrjen në sektorët më produktivë të ekonomisë, për ringritjen edhe më të fortë të tyre pas pandemisë</u>	<u>220 mijë vende të reja pune.NUK U PËRMBUSH</u>	<u>PËRMBUSHUR PIESËRISHT</u>

<u>Do të kemi një metropol Tiranë – Durrës</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	<u>Norma e papunësisë do të ulet në nivelin dyshifror (8.2%)NUK U PËRMBUSH</u>
<u>Do ta bëjmë Shqipërinë kampione të Ballkanit në këtë dekadë në turizëm, në agroturizëm dhe në eksporte bujqësore</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	<u>Dyfishim i investimeve të huaja direkte me 2 miliard EuroNUK U PËRMBUSH</u>
<u>Biznesi i vogël dhe rregullimi i problemit të pronave janë dy prioritetet e para të qeverisë së ardhshme</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	
<u>Krijohet një fond kreditimi prej 10 milionë Euro për manufakturën</u>	<u>Krijohet një fond kreditimi prej 10 milionë Euro për manufakturën (start-up)</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Nxitje transformimin e proceseve të prodhimit duke mbështetur blerjen e makinerive të industrisë 4.0 nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40%</u>	<u>Nxitje transformimin e proceseve të prodhimit duke mbështetur blerjen e makinerive të industrisë 4.0 nëpërmjet rritjes së indeksit të amortizimit nga 20% deri në 40%</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Lehtësim i procedurave të rekrutimit me 3 muaj integrim të rimbursuar për çdo punësim të ri</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	
<u>Ngritje e fashës me disa shkallë më shumë, duke e çuar tatimin 23% mbi pagën 250 mijë lekë/muaj</u>	<u>Ngritje e fashës me disa shkallë më shumë, duke e çuar tatimin 23% mbi pagën 250 mijë lekë/muaj</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>
<u>Nga 1 janari i vitit 2022 do të hiqet taksa mbi pagën aktuale deri në 40 mijë lekë</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	

<u>Paga mesatare bruto në rang vendi do të shkojë në 85 mijë lekë bruto</u>	<u>Paga mesatare bruto në rang vendi do të shkojë në 85 mijë lekë bruto</u>		<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
	<u>Rritja ekonomike do të jetë mesatarisht 4.5 % në vit dhe do të mbështesë një rritje edhe më të madhe të pagave në nivel vendi</u>	<u>Ekonomia do të rritet deri në 5.5 përqind</u> <u>NUK U PËRMBUSH</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
<u>Park industrial në Lezhë pranë zonës aeroportit të Gjadrit</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>		
<u>POLITIKAT FISKALE</u>			
<u>Pagesa e taksave do të jetë digjitale</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>		
<u>Do të vazhdojnë të përmirësohen e të shtohen marrëdhëniet me shtetin dhe lehtësirat që biznesi i madh përfituar</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>		
<u>Biznesi i vogël nuk do ketë më inspektor te dera, nuk do ketë më kontrolle fare sepse gjithçka do jetë dixhitale</u>	<u>Biznesi i vogël nuk do ketë më inspektor te dera, nuk do ketë më kontrolle fare sepse gjithçka do jetë dixhitale</u>		<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
	<u>Biznesi i vogël do t'i ketë taksat dhe TVSH-në zero deri në vitin 2029</u>		<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
<u>Prej 1 janari 2023, rimbursimi i TVSH-së do të jetë automatik</u>	<u>Prej 1 janari 2023, rimbursimi i TVSH-së do të jetë automatik</u>		<u>I PA PËRMBUSHUR</u>

	<u>Do të hiqet taksa mbi pagën aktuale deri në 40 mijë lekë</u>		<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Do të rriten me 30% pagat e administratës</u>	<u>Do të rriten me 30% pagat e administratës publike</u>	<u>Fondi i pagave në sektorin publik rritet me 68 miliard lekëNUK U PËRMBUSH</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
<u>Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>		<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
<u>Lehtësim barrës tatimore dhe kompanitë do të kenë më shumë likuiditet</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	<u>Lehtësim i barrës fiskale në 18% për të ardhurat nga pagat e lartaNUK U PËRMBUSH</u>	
<u>Reforma e fiskalizimit mbyllet brenda mandatit të tretë, me përfundimin e ngritjes së sistemit online ku do të kryhen të gjitha transaksionet dhe shërbimet.</u>	<u>NUK ËSHTË PËRFSHIRË NË PROGRAM</u>	<u>Deficit buxhetor nën nivelin prej 2 përqindNUK U PËRMBUSH</u>	
	<u>Politika e bonusit të pensioneve të fundvitit do të kthehet në një politike permanente të rritjes së pensioneve, përtej indeksimit</u>	<u>Ulim borxhin publik nën 60 përqind të PBB-sëNUK U PËRMBUSH</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>
	<u>Paketa e inovacionit dhe IT. Kostot do të rimbursohen 50% direkt dhe 50% si dyfish i tatimit të zbritshëm</u>	<u>Norma maksimale e tatimit mbi te ardhurat personale do të zbresë nga 23% që është sot në 18%NUK U PËRMBUSH</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PIESERISHT</u>

Në analizën paraprake të **përbushjes së programit të qeverisë** “Rama 3” dhe krahasuar me studimin pas afër dy vite qeverisje, ekspertët e POLIFAKT vërejnë se:

– **Për Ekonominë** nga 12 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 7 pika në programin qeverisës (ku një **pikë e re në program** është shtuar). Nga këto pika të përzgjedhura është përbushur 1 pikë programore (14% e programit ekonomik). Janë përbushur pjesërisht duke qenë drejt progresit të përbushjes 4 pika të programit (57% e programit ekonomik). Ndërkohë nuk janë përbushur 2 pika programore (29% e programit ekonomik). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se 4 pikat e papërbushura të këtij programi ekonomik është mbartur vetëm një pikë dhe 3 pikat e tjera nuk janë mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Politikat Fiskale** nga 10 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshire 7 pika në programin qeverisës. Është përbushur 1 pikë programore (14% e programit fiskal). Janë përbushur pjesërisht 5 pika programi qeverisës (71% e programit fiskal). Nuk është përbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi 1 pikë e programit (15% e programit fiskal). **Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 5 pikat e pa përbushura të këtij programi fiskal nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3” asnjë pikë.**

Po të klikoni te secila nga pikat e programit në kolonën e katërt do të shikoni edhe nivelin e përbushjes së tyre të provuar me faktet nga vetë aktiviteti i qeverisë për **Programin Qeverisës në 2021 -2025.**

Në publikimin vijues ne do të paraqesim nivelin mbi **përbushjen e premtimeve nga program qeverisës 2021 – 2023** për:

- Bujqësinë, Mjedisin dhe Turizmin
- Arsimin, Politikat Sociale, Shëndetësinë dhe Politikat e përgjithshme
- Infrastrukturën dhe Energjinë, si dhe Premtimet politike për shumë aspekte

2. Paraqitja e nivelit të përmbushjes në 600 ditë të programit bujqësor, mjedisor dhe për turizmin i Qeverisë “Rama 3”

Nisur nga gjithë baza e të dhënave për premtimet analitike, kostot e tyre, programet qeverisëse dhe analiza e përmbushjeve të tyre, ju mund të lexoni online te POLIFAKT të gjitha këto. Ndërkohë, ju mund të lexoni te posti “Të fundit” edhe publikimet që kemi bërë.

Në studimin e [premtimeve të partive kryesore](#), kur shikojmë [besueshmërinë e premtimeve zgjedhore të vitit 2021](#), sipas matjes së bërë nga POLIFAKT rezulton se:

- Nga [5 premtime për Bujqësinë](#) të PS, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, si dhe po 2 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 1 premtim është i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga [7 premtime për Mjedisin dhe Turizmin](#) të PS, 4 premtime janë pak të besueshme 3, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga [10 premtime për Bujqësinë](#) prej PD, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që 5 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga [8 premtime për Mjedisin dhe Turizmin](#) prej PD, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërsa 5 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që 10 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 7 premtime më shumë.
- Nga [7 premtime për Bujqësinë](#) të LSI, 2 premtime vlerësohen si të besueshme, 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë, 2 premtime janë pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga [2 premtime për Mjedisin dhe Turizmin](#) të LSI, 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë, 1 premtim vlerësohet pak i besueshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 2 premtime më pak.

Më poshtë janë paraqitur premtimet ekonomike dhe fiskale në fushatën e vitit 2021 të partisë socialiste (kolona e parë). Kolona e dytë janë pikat e programit, që vijnë nga përfshirja e premtimeve sipas kolonës së parë. Në kolonën e tretë prezantohen pikat e programit të pa

përmbushura nga qeveria “Rama 2” për ti krahasuar me pikat e reja të programit të ri qeverisës, si dhe për të analizuar nëse ka vijueshmëri, meqenëse kanë rezultuar të pakryera gjatë mandatit 2017-2021. Në kolonën e katërt janë paraqitur nivelet e realizimit të pikave të programit aktual qeverisës deri në fund të 600 ditëve të para të qeverisë.

2021 -2025 – QEVERIA RAMA 3 (PS)

BUJQËSIA

<u>PREMTIMET E PS 2021</u>	<u>PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE NGA QEVERIA “RAMA 3”</u>	<u>NIVELI PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 2”</u>	<u>NIVELI PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 3”</u>
<u>Eksportet bujqësore i kemi rritur në 400 milionë US. D, ishin rreth 100 milionë US.D. Do t'i çojmë mbi 1 miliardë US.D</u>	<u>Eksportet bujqësore i kemi rritur në 400 milionë US. D, ishin rreth 100 milionë US.D. Do t'i çojmë mbi 1 miliardë US.D</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESERISHT</u>
<u>Dyfishimi i numrit të bagëtive të imta nga 2 milionë në 4 milionë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Ulje TVSh-në për grumbulluesit në 6%</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
	<u>Lehtësi fiskale për sektorin bujqësor</u>	<u>PIKË E RE NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Do të garantojmë aksesin në programin IPARD III me fond financimi 166 milionë Euro</u>	<u>Do të garantojmë aksesin në programin IPARD III me fond financimi 166 milionë Euro</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>

16 milionë US.D në vitin 2025 për të mbështetur më shumë kultura të mbjelljes

16 milionë US.D në vitin 2025 për të mbështetur më shumë kultura të mbjelljes

232 milion US.D më shumë financime për Bujqësinë PA PËRMBUSHUR

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Përfundojmë shpërndarjen e certifikatave të pronës së tokës bujqësore
PA PËRMBUSHUR

70 milionë euro mbështetje të drejtpërdrejtë për fermerët nëpërmjet naftës pa akcizë dhe skemave kombëtare të mbështetjes

PIKË E RE NË PROGRAMIN OEVERISËS

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Grant 5.000 Euro për emigrantët që investojnë në agroturizëm

I PA PËRMBUSHUR

Mbi 300.000 hektarë toka bujqësore me sistem ujëjtje dhe kullimi
PA PËRMBUSHUR

MJEDISI DHE TURIZMI

Shteti shqiptar do të subvencionojë dhe operatorët turistikë

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN OEVERISËS

Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit

Paketë unike kombëtare për promovimin ndërkombëtar të destinacioneve, paketë në të cilën shteti shqiptar do të investojë 10 milionë Euro çdo vit

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

	<u>Riorganizim i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, me ligj të ri të dedikuar Menaxhimin e Integruar të Bregdetit</u>	<u>PIKË E RE NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
	<u>Reduktim me synim zhdukjen të ambalazhit plastik njëpërdorimësh</u>	<u>PIKË E RE NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
	<u>Menaxhim i integruar i mbetjeve në tërësinë e territorit sipas Masterplanit</u>	<u>PIKË E RE NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Zona të reja të zhvillimit turistik, në total 6 zona</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Do të konsolidohen 4 destinacione turistike kombëtare: Alpet Shqiptare, Jugu i Ri, Portet e Marinat, Tirana</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik</u>	<u>Agroturizmi do të mbështetet jo vetëm financiarisht, por edhe me harta, rrugë, infrastrukturë lokale, promovim unik</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Muzeu i ri Etnografik në Gjirokastrë dhe bypass i zonës historike</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Muze historik në Tepelenë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Qendër e re turizmi në Korçë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		

Në analizën paraprake të **përbushjes së programit të** qeverisë “Rama 3” dhe krahasuar me studimin pas afër dy vite qeverisje, ekspertët e POLIFAKT vërejnë se:

– **Për Bujqësinë** nga 5 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 8 pika në programin qeverisës (ku tre pika janë të reja në program është shtuar). Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 2 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë përbushur 5 pika programore (63% e programit për bujqësinë). Ndërkohë nuk janë përbushur 3 pika programore (37% e programit ekonomik). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 3 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Mjedisin dhe Turizmin** nga 7 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 2 pika në programin qeverisës. Ndërsa, 4 pikat e tjera të programit qeverisës janë pika të reja të përmendura gjatë fushatës së vitit 2021.

Nga programi për mjedisin dhe turizmin është përbushur 1 pikë programore (17% e programit për mjedisin dhe turizmin). Janë përbushur pjesërisht 4 pika programi qeverisës (66% e programit fiskal). Nuk është përbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi 1 pikë e programit (17% e programit fiskal). **Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se 1 pikë e papërbushur e këtij programi nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”.**

Po të klikoni te secila nga pikat e programit në kolonën e katërt do të shikoni edhe nivelin e përbushjes së tyre të provuar me faktet nga vetë aktiviteti i qeverisë për **Programin Qeverisës në 2021 -2025**.

Në publikimet vijuese ne do t’ju paraqesim **përbushjen e premtimeve nga program qeverisës 2021 – 2023** për:

- Arsimin, Politikat Sociale, Shëndetësinë dhe Politikat e përgjithshme
- Infrastrukturën dhe Energjinë, si dhe Premtimet politike për shumë aspekte

3. Përmbushja e programit të qeverisë “Rama 3” për arsimin, gruan, Rininë, Shëndetësinë, politikat sociale dhe sektoriale

Në studimin e premtimeve të partive kryesore, kur shikojmë besueshmërinë e premtimeve zgjedhore të vitit 2021, sipas matjes së bërë nga POLIFAKT rezulton se:

- Nga 16 premtime për Arsimin, Gruan, Rininë të PS, 4 premtime vlerësohen si të besueshme, por 10 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 2 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 3 premtime më pak.
- Nga 2 premtime për Politikat Sociale të PS, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërkohë, 1 premtim konsiderohet i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 5 premtime më pak.
- Nga 10 premtime për Shëndetësinë të PS, 3 premtime janë pak të besueshme, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 4 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga 9 premtime për Kulturën, Digjitalizimin dhe Politikat të PS, 2 premtime janë të besueshme, ndërsa 1 premtim konsiderohet si i pamatshëm. Ndërkohë që, 6 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga 18 premtime për Arsimin, Gruan, Rinin të PD, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, por 10 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 5 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 11 premtime më pak.
- Nga 11 premtime për Politikat Sociale të PD, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, ndërkohë, 8 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 8 premtime më shumë.
- Nga 9 premtime për Shëndetësinë të PD, 2 premtime janë pak të besueshme, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 4 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 8 premtime më shumë.
- Nga 34 premtime për Politikat dhe Administrative të PD, 9 premtime janë të besueshme, ndërsa 11 premtime konsiderohen si të pamatshëm. Ndërkohë që, 14 premtime vlerësohen si pak

të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 18 premtime më shumë.

– Nga **18 premtime për Arsimin, Gruan, Rininë** të LSI, 4 premtime vlerësohen si të besueshme, 9 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 5 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 16 premtime më shumë.

– Nga **4 premtime për Politikën Sociale** të LSI, 1 premtim vlerësohet si i besueshëm, ndërkohë 2 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.

– Nga **3 premtime për Shëndetësinë** të LSI, 3 premtime janë pak të besueshme, ndërsa 2 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 2 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.

– Nga **5 premtime për Administrimin dhe Politikën** të LSI, 1 premtim është i besueshëm, ndërsa 1 premtim konsiderohen si i pamatshëm. Ndërkohë që, 6 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.

Më poshtë janë paraqitur premtimet ekonomike dhe fiskale në fushatën e vitit 2021 të partisë socialiste (kolona e parë). Kolona e dytë janë pikat e programit, që vijnë nga përfshirja e premtimeve sipas kolonës së parë. Në kolonën e tretë prezantohen pikat e programit të papërbushura nga qeveria “Rama 2” për ti krahasuar me pikat e reja të programit të ri qeverisës, si dhe për të analizuar nëse ka vijueshmëri, meqenëse kanë rezultuar të pakryera gjatë mandatit 2017-2021. Në kolonën e katërt janë paraqitur nivelet e realizimit të pikave të programit aktual qeverisës deri në fund të 600 ditëve të para të qeverisë.

2021 -2025 – QEVERIA RAMA 3 (PS)

ARSIMI, GRUAJA, RINIA

<u>PREMTIMET E PS 2021</u>	<u>PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE NGA QEVERIA “RAMA 3”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 2”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 3”</u>
<u>Universitete të spikatura publike të vendeve mike, të jenë integruar në sistemin e</u>	<u>Universitete të spikatura publike të vendeve mike, të jenë integruar në sistemin e arsimit tonë të lartë publik</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PJESERISHT</u>

<u>arsimit tonë të lartë publik</u>			
<u>Programet profesionale do t'i çojmë në një nivel tjetër, në bashkëpunim të ngushtë me universitetet publike dhe private dhe me aktorët e tregut</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>40% gra në vendimmarrje në proceset publike, drejtuese dhe ligjvënësve</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Universitetet tona do të njehsohen me universitete publike europiane apo të vendeve të tjera mike</u>	<u>Universitetet tona do të njehsohen me universitete publike europiane apo të vendeve të tjera mike</u>	<u>Do të ulim me 10% punën e papaguar të grave</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESERISHT</u>
<u>Do të mbështesim çdo sinergji të plotë mes një universiteti shqiptar dhe një të huaj publik në anglisht</u>	<u>Do të mbështesim çdo sinergji të plotë mes një universiteti shqiptar dhe një të huaj publik në anglisht</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESERISHT</u>
<u>Dixhitalizimi i gjithë sistemit para universitar</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>100% e fëmijëve romë e egjiptianë do kryejnë arsimin e detyruar</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Paketa e inovacionit do të ofrojë kualifikime në novacion duke mbuluar kostot 100% nga qeveria</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Transformim i 18 shkollave të mesme në shkolla ekselence sipas sistemit dual</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Fuqizim të kurseve të personalizuar për fëmijët</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Çdo bashki me një shkollë profesionale për nevojat e tregut lokal</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	

Deri në vitin 2025, të gjithë drejtuesit e shkollave do të licensohen nga shkolla e drejtorëve si menaxherë të kualifikuar

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS

Financim me 10 milion Euro në vit për universitet për afrimin e studimit me vendet e BE

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS

Edukimi fizik do të zënë një vend më të rëndësishëm në sistemin arsimor, nga klasa e parë deri në universitet

Edukimi fizik do të zërë një vend më të rëndësishëm në sistemin arsimor, nga klasa e parë deri në universitet

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR

Do të çelim programin kombëtar të arteve dhe zejeve për të gjithë nxënësit e shkollave të mesme

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS

Krijimi i një sistemi virtual alternativ shkollimi, me lidhje apo pa lidhje të domosdoshme në internet

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS

Mbyllja përfundimtare e praktikës së vjetër të klasave kolektive në zonat e largëta, nisur nga eksperiencia e pandemisë

NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS

	<u>Në vitin 2021 vijon rikonstruktimi i 120 shkollave të reja, ku studiojnë 40 mijë nxënës më shumë</u>	<u>Ndërtojmë 140 shkolla të reja model për 40 mijë nxënës</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESERISHT</u>
<u>Do të ngremë kampusin e ri Universitetit Tiranës, si dhe do të përfundojmë kampusin e Universitetit Bujqësor, Akademisë së Arteve, Universitetit Politeknik dhe Akademisë së Sigurisë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Program Kombëtar 10 vjeçar për kodimin për fëmijët 12-18 vjeç dhe qendra të specializuara të hyrjes në botën digjitale</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Arsimi parashkollor i detyrueshëm në fund të mandatit</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Fundi i mësimit me dy turne për shkak të mungesës së klasave deri në 2025</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Mundësim i ushqimit në shkollë dhe rritje e kohëqëndrimit</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Gjuha angleze do të nisë të mësohet në të gjithë shkollat e vendit që nga klasa e parë</u>	<u>Gjuha angleze do të nisë të mësohet në të gjithë shkollat e vendit që nga klasa e parë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PERMBUSHUR</u>
<u>Pagat e arsimtarëve do të rriten me 40%</u>	<u>Pagat e arsimtarëve do të rriten me 40%</u>		<u>PERMBUSHUR</u> <u>PJESERISHT</u>

Libra falas për të gjithë nxënësit e arsimit para-universitar

Libra falas për të gjithë nxënësit e arsimit para-universitar

PERMBUSHUR

POLITIKAT SOCIALE

Subvencionimin me pagesë me çerdhet dhe kopshtet private, për subvencionimin e pagesës në rastet e pamundësisë së gjetjes së vendeve të lira në strukturat shtetërore

Subvencionimin me pagesë me çerdhet dhe kopshtet private, për subvencionimin e pagesës

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Brenda vitit 2022, përfundon ndërtimi i rreth 12 mijë apartamenteve në lagjet e reja dhe rehabilitimi i 160 shkollave

Brenda vitit 2022, përfundon ndërtimi i rreth 12 mijë apartamenteve në lagjet e reja dhe rehabilitimi i 160 shkollave

Transformojmë Ndhimën Ekonomike në Program për riintegrim social
PA PËRMBUSHUR

I PA
PËRMBUSHUR

Zgjerojmë mbulimin e familjeve të varfra me skemën e ndihmës ekonomike, me përparësi familjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian, me 10% në vit

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Zgjerojmë skemën e mbulimit të familjeve dhe individëve në nevojë si dhe risim aksesin ndaj punësimit

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Programi për nënat dhe fëmijët

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

<u>Rrisim me 10% përfshirjen e grave kryefamiljare në skemën e ndihmës ekonomike</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Rrisim numrin e grave kryefamiljare, personave me aftësi të kufizuara, jetimëve dhe komunitetit rom e egiptian si përfitues prioritarë të programit social për strehimin</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESËRISHT</u>
<u>Nëpërmjet Fondit Social, do të zgjerohet rrjeti i qendrave dhe shërbimeve të reja në territor për fëmijët, gratë dhe të moshuarit në nevojë në të gjitha bashkitë e vendit si dhe do të mbështetet krijimi i 11 ndërmarrjeve sociale me qëllim mbështetjen e grave dhe vajzave</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESËRISHT</u>
<u>Programi i banesave sociale në bashkitë e mëdha me prurje të lartë demografike, do të ndërtohen rreth 2.000 banesa në vit për familjet</u>	<u>Paketa e solidaritetit për pensionistët 24 miliard lekë</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESËRISHT</u>
<u>Familjeve të reja do t'u ofrojmë 1 milion lekë mbështetje për pagesën fillestare dhe zbutjen e interesit për blerjen e shtëpisë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>I PA</u> <u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Adresojmë pabarazinë mes kategorive të ndryshme sociale të shkaktuar nga Pandemia</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u> <u>PJESËRISHT</u>
	<u>Rritje vjetore pensionesh dhe shpërblim fundviti nga 7-10 mijë lek</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	

SHËNDETËSIA

<u>Mjekët do të fillojmë t'i paguajmë jo të gjithë njësoj, por sipas performancës së tyre</u>	<u>Mjekët do të fillojmë t'i paguajmë jo të gjithë njësoj, por sipas performancës së tyre</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
	<u>I japim përparësi parandalimit të sëmundjeve të transmetueshme dhe jo të transmetueshme</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Do të ndryshojmë administrimin e brendshëm të spitaleve</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri</u>	<u>Pagën për mjekët dhe infermierët do ta rrisim 40% përsëri</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>6 spitale rajonale me shërbim të ri të obstetri gjinekologjisë dhe pediatriisë.</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>4 spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese</u>	<u>4 spitale rajonale të transformuar në qendra reference diagnostikuese</u>		<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare</u>	<u>Vendosja në punë e 10 qendrave model të mjekësisë familjare</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
	<u>Vaksinimi i popullatës kritike, personat në moshë mbi 60 vjeç dhe ata me sëmundje bashkëshoqëruese do të ketë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>

	<u>përfunduar brenda shtator 2021.</u>		
<u>100 qendra shëndetësore dhe ambulanca të rehabilituara deri në vitin 2024</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor</u>	<u>Rimodelimi i financimit publik për shëndetësinë, modernizimin e sistemit shëndetësor</u>		<u>PËRMBUSHUR PËJESERISHT</u>
<u>Ndërtimi i spitalit të ri të Laçit</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Spital i ri rajonal në Shkodër, i njëjtë me standardet e spitalit të Fierit</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
	<u>Ndërtojmë një sistem të dhënash që garanton informacion për “shpërndarjen” dhe aksesin në shëndetësi të popullatës, që mundëson një monitorim konstant për adresimin e pabarazive.</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PËJESERISHT</u>
	<u>Nxsisim inovacionin dhe rritjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit në shëndetësi</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PËJESERISHT</u>
	<u>Brenda 2021 shqiptarët do kenë shërbimet shëndetësore falas</u>	<u>PA PËRMBUSHUR</u>	

KULTURA, DIGJITALIZIMI

**Asgjësojmë
korrupsionin që
ka të bëjë me
marrëdhëniet që
zgjidhen nga
shteti dixhital**

**NUK U PËRFSHI NË
PROGRAMIN QEVERISËS**

**PËRMBUSHUR
PJESËRISHT**

**Dixhitalizimi i të
gjithë arkivave
fizike për ta rritur
numrin e
shërbimeve dhe
për ta bërë
shërbimin
automatik**

**NUK U PËRFSHI NË
PROGRAMIN QEVERISËS**

**PËRMBUSHUR
PJESËRISHT**

**Marrja e
përgjigjes online
me nënshkrim,
vulë elektronike
për të gjitha
shërbimet në e-
albania që janë
aplikime**

**Marrja e përgjigjes online me
nënshkrim, vulë elektronike
për të gjitha shërbimet në e-
albania që janë aplikime**

PËRMBUSHUR

**Pagesa e taksave
do të jetë digjitale**

**NUK U PËRFSHI NË
PROGRAMIN QEVERISËS**

**Do të vazhdojnë
të përmirësohen e
të shtohen
marrëdhëniet me
shtetin dhe
lehtësirat që
biznesi i madh
përfutuar**

**NUK U PËRFSHI NË
PROGRAMIN QEVERISËS**

**Krijimin e një
shteti dixhital në
të gjitha
shërbimet**

**Krijimin e një shteti dixhital
në të gjitha shërbimet**

**PËRMBUSHUR
PJESËRISHT**

**Zero rritje të
pagës së
deputetëve dhe**

**NUK U PËRFSHI NË
PROGRAMIN QEVERISËS**

ministrave deri në
2025

Përfundojmë projektin e
Rijetëzimit të Amfiteatrit
Durrës

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Fillojmë punimet për
ndërtimin e Muzeut Hebraik
Shqiptar si pjesë integrale e
projektit të rivitalizimit të
Oendrës Historike të Vlorës

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Ndërtojmë Parkun e Artit

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Vendosim në funksionim
Skemën Kombëtare "Bonusi i
Rijetëzimit"

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR

POLITIKA TË TJERA

Reforma në
Drejtësi dhe
domosdoshmëria
për të konsoliduar
pozicionin e
drejtësisë së re

Reforma në drejtësi

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Do të mbyllim
përfundimisht
pronën si çështje,
qoftë në qytet,
qoftë në fshat

Siguria e pronës

I PA
PËRMBUSHUR

Shqipëria e sigurtë

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Hartim plan-veprimi për
çmontimin e korrupsionit,
PA PËRMBUSHUR

Në analizën paraprake të **përbushjes së programit të qeverisë “Rama 3”** dhe krahasuar me studimin pas afër dy vite qeverisje, ekspertët e POLIFAKT vërejnë se:

– **Për Arsimin, Gruan, Rininë** nga 16 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 8 pika në programin qeverisës (ku 4 pika janë të reja në program është shtuar). Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 12 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë përbushur 3 pika programore (38% e programit për arsimin). Ndërkohë janë në progres përbushje 5 pika programore (62% e programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 8 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Politikat Social** nga 2 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë të 2 pikat në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 9 pika janë të reja në programin social. Nga pikat e programit është përbushur 1 pikë programore (9% e programit social). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 8 pika programi (73% e programit social). Nuk janë përbushur 2 pika programore (18% të programit social). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 3 pikat e papërbushura të këtij programi nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Shëndetësinë** nga 10 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 5 pika në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 4 pika janë të reja në programin social. Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 5 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit është përbushur 1 pikë programore (11% e programit për shëndetësinë). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 7 pika programi (78% e programit). Nuk është përbushur ende 1 pikë programore (11% të programit). **Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga 1 pikë e papërbushur e këtij program nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.**

– **Për Kulturën, Digjitalizimin dhe Politika** nga 9 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 4 pika në programin qeverisës. Ndërsa, 5 premtimet e tjera nuk u përfshinë në programin qeverisës. Janë shtuar 6 pika të reja të papërmendura gjatë fushatës së vitit 2021 ashtu si paraqiten në program.

Nga programi për kulturën dhe digjitalizimin janë përbushur 2 pikë programore (20% e programit). Janë përbushur pjesërisht 6 pika programi qeverisës (60% e programit fiskal). Nuk ka pika të papërbushura.

Nga programi për politikën në drejtësi dhe pronë është në progres për tu përbushur 1 pikë programore (10% e programit). Nuk është përbushur apo nuk ka asnjë shenjë të provuar realizimi për 1 pikë e programit (10% e programit).

Nëse shikojmë mbartjen e programit fiskal të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se [nga 2 pika te papërbushura te këtyre programeve](#) nuk është mbartur në programin e qeverisë “Rama 3”. Po të klikoni te secila nga pikat e programit në kolonën e katërt do të shikoni edhe nivelin e përbushjes së tyre të provuar me faktet nga vetë aktiviteti i qeverisë për [Programin Qeverisës në 2021 -2025](#).

Në publikimet vijuese ne do t’ju paraqesim [përbushjen e premtimeve nga program qeverisës 2021 – 2023](#) për [Infrastrukturën](#) dhe [Energjinë](#), si dhe për [Politikën e Jashtme](#)

4. Programi qeverisës “Rama 3” për Infrastrukturën, Energjinë dhe Politikën e jashtme në pamundësi përmbushje

Në studimin e premtimeve të partive kryesore, kur shikojmë besueshmërinë e premtimeve zgjedhore të vitit 2021, sipas matjes së bërë nga POLIFAKT rezulton se:

- Nga 9 premtime për Energjinë të PS, 3 premtime vlerësohen si të besueshme, 3 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 3 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 4 premtime më shumë.
- Nga 21 premtime për Infrastrukturën të PS, 6 premtime vlerësohen si të besueshme. Ndërsa 5 premtime vlerësohen si të pamatshme. Ndërkohë, 10 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 11 premtime më shumë.
- Nga 1 premtim për Politikën e Jashtme të PS, konsiderohet si i pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga 17 premtime për Energjinë të PD, 4 premtime vlerësohen si të besueshme, por 9 premtime janë pak të besueshme. Ndërkohë, 4 premtime konsiderohen të pamatshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 13 premtime më shumë.
- Nga 3 premtime për Infrastrukturën të PD, 3 premtime konsiderohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga 9 premtime për Politikën e Jashtme të PS, 2 premtime janë pak të besueshme, ndërsa 3 premtime konsiderohen si të pamatshme. Ndërkohë që, 4 premtime vlerësohen si pak të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 8 premtime më shumë.
- Nga 6 premtime për Politikën e Jashtme të PD, 4 premtime janë të besueshme, ndërsa 2 premtime konsiderohen si të pamatshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 6 premtime më shumë.
- Nga 2 premtime për Energjinë të LSI, të 2 premtimet vlerësohen si të besueshme. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.
- Nga 1 premtim për Infrastrukturë të LSI, ai vlerësohet si i besueshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 nuk ka ndryshim.
- Nga 1 premtim për Politikën e Jashtme të LSI, 1 premtim është i besueshëm. Në krahasim me sasinë e premtimeve në vitin 2017 vërehet se ka 1 premtim më shumë.

Më poshtë janë paraqitur premtimet ekonomike dhe fiskale në fushatën e vitit 2021 të partisë socialiste (kolona e parë). Kolona e dytë janë pikat e programit, që vijnë nga përfshirja e premtimeve sipas kolonës së parë. Në kolonën e tretë prezantohen pikat e programit të papërbushura nga qeveria “Rama 2” për ti krahasuar me pikat e reja të programit të ri qeverisës, si dhe për të analizuar nëse ka vijueshmëri, meqenëse kanë rezultuar të pakryera gjatë mandatit 2017-2021. Në kolonën e katërt janë paraqitur nivelet e realizimit të pikave të programit aktual qeverisës deri në fund të 600 ditëve të para të qeverisë.

2021 -2025 – QEVERIA RAMA 3 (PS)

ENERGJIA

<u>PREMTIMET E PS 2021</u>	<u>PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE NGA QEVERIA “RAMA 3”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 2”</u>	<u>NIVELI I PËRMBUSHJES SË PROGRAMIT “RAMA 3”</u>
<u>Dy investime madhore me amerikanët, në Skavicë dhe në TEC-in e Vlorës për gazin e lëngshëm</u>	<u>Dy investime madhore me amerikanët, në Skavicë tjetrin në TEC-in e Vlorës për gazin e lëngshëm</u>	<u>Fillimi i ndërtimit të gazsjellësit Adriatiko-Jonian (IAP). PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Vlora një qendër rajonale për gazin e lëngshëm natyror</u>	<u>Vlora një qendër rajonale për gazin e lëngshëm natyror</u>		<u>PËRMBUSHUR PJESËRISHT</u>
<u>Do ta çojmë në mandatin e tretë nivelin e humbjeve teknike në energji në 10%</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Përfundim i procesit të liberalizimit të tregut të energjisë për Tensionit të Lartë dhe Tensionit të Mesëm PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Park i prodhimit të energjisë së erës në Lezhë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		

<u>Do të fuqizojmë aspektin teknologjik smart, digjital, në monitorim e në operim përmes një sistemi që tanimë është i instaluar në Shqipëri</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN OEVERISËS</u>	<u>Zvogëlimi i humbjeve në rrjet jo më shumë se 20%. PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Do të vijojmë të ndërtojmë një rrjet të ri 20 kilovolt me një seri kabinash të tjera</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN OEVERISËS</u>		
<u>Do të rrisim sigurinë e furnizimit për të gjithë, përmes fuqizimit pikërisht të kapaciteteve të shpërndarjes së energjisë elektrik</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN OEVERISËS</u>		
<u>Do të ndërtojmë e të transformojmë nënstationet e tjera në rang vendi</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN OEVERISËS</u>		
<u>Shqipëria kthehet në eksportues neto të energjisë</u>	<u>Shqipëria kthehet në eksportues neto të energjisë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>
	<u>Bursa Shqiptare e Energjisë do të bëhet krejtësisht operacionale në Shkurt të vitit 2022</u>	<u>Krijimi i bursës së energjisë dhe krijimi i tregut të organizuar të energjisë PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
	<u>Nisim punimet për ndërtimin e Parkut Fotovoltaik të Karavastasë prej 140 MW, më i madhi në Ballkan, në pranverën e vitit të ardhshëm (Mars 22)</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PERMBUSHUR PËSËRISHT</u>

INFRASTRUKTURA

<u>Kritje e buxhetit për ujin në mandatin e tretë, me 40%, nga buxheti i shtetit dhe mbështetjes nga fondet e huaja</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Ujë të pijshëm 100% në 24 orë, brenda vitit 2022, në zonat urbane të 61 bashkive të vendit</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Projekt mbi lidhjen e linjës mes Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, duke e futur rrjetin hekurudhor në kontekstin e një rrjeti rajonal të transportit hekurudhor</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>
<u>“Air Albanian” duam ta çojmë në fluturimet përtej oqeanit</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Akset Fushë-Krujë – Shkodër (zgjerim).</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Porti i ri turistik i Lezhës, porti i katërt i zinxhirit porteve</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Ndërtimi Thumanë-Kashar/Vorë</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Ndërtimi i aeroportit të ri në Korçë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Rrjeti qendror TEN-T Core</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Do rikthejmë si projekt prioritar Boshtin e Jugut, nga Hani i Hotit deri në Përmet</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Shtrirja e rrjeteve të kanalizimeve për largimin e ujërave të ndotur urbane, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 48 %.</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Linja e re hekurudhore Pogradec-Korçë-Greqi</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Shtrirja e shërbimit të furnizimit me ujë, që do të arrijë në nivel kombëtar në masën 75 %.</u> <u>PA PËRMBUSHUR</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Brenda vitit 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit</u>	<u>Brenda vitit 2021, përfundimi i Rrugës së Arbrit</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>

<u>Brenda vitit 2022, përfundon ndërtimi i rreth 12 mijë apartamenteve në lagjet e reja dhe rehabilitimi i 160 shkollave</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Në Dhjetor 2021 përfundon e gjithë Unaza e Madhe të Tiranës</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		<u>IPA PËRMBUSHUR</u>
<u>Porti i Durrësit me investimin prej 2 miliardë Euro pas marrëveshjes së bashkëpunimit me Qeverinë e Emirateve të Bashkuara</u>	<u>Porti i Durrësit me investimin prej 2 miliardë Euro</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Përfundimi brenda verës i dy akseve Tepelenë-Lekdush dhe Gusmar-Kuç</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Ndërtimi i segmentit rrugor "Orikum – Llogara"</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Ndërtimi i segmentit "Thumanë – Kashar"</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Ndërtimi i rrugës "Kardhiq-Delvinë"</u>	<u>Ndërtimi i rrugës "Kardhiq-Delvinë" do të përfundojë tërësisht në pranverën e vitit të ardhshëm (Maj 2022)</u>		<u>IPA PËRMBUSHUR</u>
<u>Ndërtimi i 2 aerodromeve në Gjirokastrë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>	<u>Ndërtimi infrastrukturor aeroportual në jug të vendit. PA PËRMBUSHUR</u>	
<u>Ndërtimi i aeroportit në Vlorë</u>	<u>Ndërtimi i aeroportit në Vlorë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>

<u>Ndërtimi i aeroportit të ri në Sarandë</u>	<u>Ndërtimi i aeroportit të ri në Sarandë</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR PËSËRISHT</u>
<u>Port i ri turistik në Sarandë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>30.7 miliardë Lekë (rreth 245 milionë Euro) ku pjesa kryesore (14.6 miliardë Lekë) do të jetë për grante rikonstruksioni e rindërtimi dhe (6.8 miliardë Lekë) për banesat</u>	<u>30.7 miliardë Lekë ku pjesa kryesore do të jetë për grante rikonstruksioni e rindërtimi dhe për banesat</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>
<u>Projekt i infrastrukturës turistike në Vlorë, që do të lidhë Ujin e Ftohtë me Radhimën e Orikumin</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Rindërtimi i sheshit të Flamurit</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Rrjet i ri ujësjellësi në Vlorë, furnizim 24 orë me ujë</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
<u>Ndërtimi i 3 porteve në Vlorë, porti turistik, porti i mallrave dhe porti i peshkatarëve</u>	<u>NUK U PËRFSHI NË PROGRAMIN QEVERISËS</u>		
	<u>28 kantiere të reja të infrastrukturës publike do të kenë përfunduar deri në pranverën e vitit 2022</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>I PA PËRMBUSHUR</u>
	<u>Nisim brenda vitit punimet për Hekurudhën Tiranë-Rinas-Durrës</u>	<u>PROGRAM I RI</u>	<u>PËRMBUSHUR</u>

POLITIKË E JASHTME

E çojmë Shqipërinë në një nivel tjetër që të jetë në një pozicion që nuk mund të kthehet më pas

E çojmë Shqipërinë në një nivel tjetër që të jetë në një pozicion që nuk mund të kthehet më pas

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Integrimi Evropian

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Mbrojmë interesat e gjithë shqiptarëve

PROGRAM I RI

PËRMBUSHUR
PJESËRISHT

Në analizën e pjesshme të **përbushjes së programit të qeverisë** “Rama 3” dhe krahasuar me studimin pas afër dy vite qeverisje, ekspertët e POLIFAKT vërejnë se:

– **Për Energjinë** nga 9 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 3 pika në programin qeverisës dhe dy programe të reja nuk janë pjesë e premtimeve të përmendura gjatë fushatës zgjedhore. Nuk janë përfshirë në programin qeverisës 6 premtime të përmendura gjatë fushatës zgjedhore 2021. Nga pikat e programit janë në progres përbushje 4 pika programore (80% e programit) dhe nuk është përbushur ende 1 pikë programore (20% të programit). Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga **4 pikat e papërbushura të këtij programi** nuk është mbartur vetëm një prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.

– **Për Infrastrukturën** nga 21 premtime në fushatën zgjedhore janë përfshirë 6 pika në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 2 pika janë të reja në programin social. Nga pikat e programit janë përbushur 2 pika programore (25% e programit). Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 3 pika programi (37% e programit social). Nuk janë përbushur 3 pika programore (38% të programit). Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga **7 pikat e papërbushura të këtij programi** nuk është mbartur asnjë prej tyre në programin e qeverisë “Rama 3”.

– **Për Politikën e Jashtme** nga 1 premtim në fushatën zgjedhore është përfshirë si pikë në programin qeverisës, si dhe janë shtuar edhe 2 pika janë të reja në programin e politikës së jashtme. Nga pikat e programit nuk është përbushur asnjë pikë programore. Janë në progres përbushje apo priten të përbushen deri në 3 pika programi (100% e programit). Nëse shikojmë mbartjen e programit ekonomik të qeverisë “Rama 2”, vërejmë se nga **nuk ka patur asnjë pikë të papërbushur te programit** për tu mbartur në programin qeverisë “Rama 3”.

SHTOJCA

Programi i qeverisë Rama 2 ishte i mbështetur në 3 priorite qeverisëse.

Prioriteti i parë ishte “**rritja e qëndrueshme gjithëpërfshirëse**”. Rritja ekonomike cilësore, inteligjente dhe gjithëpërfshirëse vlerësohet si burimi kryesor në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Gjatë mandatit 2017-2021, Qeveria “Rama 2” deklaroi se angazhohet me prioritet në konsolidimin e stabilitetit makroekonomik, rritjen e punësimit, zhvillimin e infrastrukturës, sektorit energjetik e minerar, bujqësisë, agroindustrisë dhe turizmit. Në këtë mënyrë, tashmë prioriteti kryesor i qeverisë është pikërisht ekonomia.

Ministritë 2017 - 2021, sipas Programit

Prioriteti 1
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Kulturës
Prioriteti 2
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Brendshme
AKSHI, ASPA (Institucione nga Kryeministri)
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Prioriteti 3
Ministria për Punët e Jashtme dhe Europën
Ministria e Mbrojtjes
Ministër i Shtetit për Diasporën
Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Ministri i Shtetit për Rindërtimin

Për zbatimin e prioritetit më të rëndësishëm për këtë qeveri u kompozua edhe konsolidimi i funksioneve të ekonomisë dhe financave nën një ministri, konsolidimi i funksioneve të turizmit dhe mjedisit në një Ministri të re, si dhe funksionet e energjisë, industrisë, transportit, zhvillimit urban, telekomunikacionit dhe infrastrukturës (rrugore, ujore, hekurudhore dhe aeroportuale).

Një kabinet me funksione të shumta ministrore (6 funksione) brenda këtyre ministrive është një risi që nuk është aplikuar nga asnjë qeveri pas viteve '90.

Ministritë që kanë fusha mbulimi këtë prioritet sipas linjave përkatëse sektoriale janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e konsideruar në ndërveprim në funksion të ekonomisë turistike edhe Ministria e Kulturës.

Edhe *prioriteti i dytë* “Shërbimet publike” konsiderohet si mjaft i lidhur ngushtë me prioritetin e parë. Në këtë prioritet renditet prioriteti i reformimit të drejtësisë, siguria dhe rendi publik, administrata publike dhe digjitalizimi, arsimi, sporti, rinia, shëndetësia dhe kujdesi social.

Vihet re se në qeverinë Rama 1 mbulimin e çështjeve për rininë i mbulonte Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Në qeverinë Rama 2, mbulimi i çështjeve të rinisë ka kaluar te Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ndryshimi i fushës së mbulimit në vendimet e KM nuk ka argumentime specifike, por gjithsesi lëvizja nga një ministri te tjetra krijon probleme në lidhje me

fokusin, si dhe ndjekjen konsistente të politikave, përtej synimit për përmirësim të politikës dhe vëmendjes së shtuar, që në Program përfaqësohet me një vëmendje rutinore.

Prioriteti i tretë përmbledh "Politikën e jashtme dhe sigurinë, Integrimin evropian dhe shqiptarët në botë". Në këtë prioritet, shikohet një zhvendosje e prioriteteve të qeverisë Rama 2 në krahasim me programin e qeverisë Rama 1. Në programin e qeverisë Rama 2 integrimi nuk është renditur si prioriteti kryesor, por në vend të tretë, duke e përfshirë fushën e mbulimit për integrimin brenda Ministrisë së Jashtme, e cila ndryshon edhe emërtimin në Ministria për Punët e Jashtme dhe Europën. Për herë të parë krijohet një Ministri e re pa portofol për Diasporën. Në po këtë prioritet janë zhvendosur edhe Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Një Ministri për mbrojtjen e Sipërmarrjes u krijua e re. Pas tërmetit të Nëntori 2019 u krijua edhe një Ministri e re me fushë mbulimi rindërtimin e dëmeve të tërmetit, koordinimin me ministrinë e tjera, si dhe mbulimin më vonë edhe të administrimit të problematikave dhe masave administrative dhe financiare në adresim të daljes me sa më pak dëme nga pandemia e Covid-19.

Programi i qeverisë Rama 3 mbështetet në 5 shtylla kryesore:

1. Rimëkëmbje e ekonomisë nga tërmeti dhe pandemia;
2. Mirëqenie për të gjithë, që do të përkthehet në një ekonomi të zhvilluar që krijon shanse për të gjithë.
3. Modernizim për zhvillim të ekonomisë prodhuese, turizmit, energjisë, bujqësisë, ekonomisë digjitale, transporteve dhe shërbimeve;
4. Familja si themeli ku ndërtojmë të ardhmen;
5. Shqipëri e fortë, me shtet të fortë, vëmendje për çdo Shqiptar dhe me dinjitet në botë.

Në kompozimin e Kabinetit të ri në strukturën e qeverisë nuk ka ndryshime të numrit të ministrive, por pushim nga funksioni dhe krijim të ministrive të reja.

Ministri i Shtetit për Diasporën ka pushuar së funksionuari. Po ashtu edhe Ministri i Shtetit për Rindërtimin ka pushuar së funksionuari.

Funksionet e *Ministrit të Shtetit për Diasporën* duket se janë transferuar te Ministria për Punët e Jashtme dhe Europën.

Dy ministri të reja janë krijuar:

- *Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët* (janë zhvendosur përsëri çështjet e rinisë nga Ministria e Arsimit, Sporti dhe Rinisë te Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, duke shtuar edhe çështjen e fëmijëve, që si fushë mbulimi lidhet me premtimet për kodimin, zejet, dhe aktivizimin e sportit nëpër shkolla.

- *Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet*, si një zhvendosje tashmë të funksioneve që kanë qenë në disa ministri dhe të cilat duket se do të përmbledhen në ministrinë e re pa portofol, si

koordinatore e standartizimit dhe mbulimit të harmonizimit të politikave të shërbimeve ndërsektoriale.

Edhe pse është e vështirë të bësh një ndarje të ministrive në varësi të shtyllave kryesore, sipas linjës sektoriale, ne kemi bërë një ndarje bazuar mbi renditjen e objektivave kryesore qeverisëse. Programi qeverisës Rama 3 ka një strukturë jo të lehtë për të identifikuar qartë brenda të njëjtës shtyllë detyra që mbulon vetëm një ministri.

Në zbatim të *shtyllës së parë* “Lufta me pandeminë Covid-19 dhe një Strategji e re për shëndetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm” është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (ka ndryshuar emërtimin nga “Mbrojtje sociale” në “Mirëqenie sociale”), në bashkëveprim me disa Ministri (Financat dhe Ekonomia, Bujqësia, Mjedisi). Kjo bashkëlidhje e Ministrisë për mbulimin e funksioneve të shtyllës së parë lidhet me shërbimet për mbrojtjen nga pandemia, si dhe ato që ka fushë mbulimi të linjës. Lufta me pandeminë Covid-19, si dhe politikat për vaksinimin janë ndër detyrat më prioritare të qeverisë Rama 3.

Në këtë orientim përfshihen edhe premtimet për shëndetësinë duke i koordinuar me bujqësinë dhe mjedisin. Por roli i zhvillimit të qëndrueshëm buron pikërisht nga bashkëveprimi midis ministrive si më lart.

Në mbulim të *shtyllës së dytë* “Mirëqenie për të gjithë” është Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në fushën e mbulimit janë objektiva që i monitorin dhe administrojnë Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e vartësisë.

Ministritë 2021 - 2025*
Shtylla 1
Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Shtylla 2
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministër Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Shtylla 3
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministri i Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Kulturës
Shtylla 4
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
Ministri i Shtetit për Standartet dhe Shërbimet
Shtylla 5
Ministria e Drejtësisë
Ministria për Punët e Jashtme dhe Europën
Ministria e Brendshme
Ministria e Mbrojtjes
Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Shtylla e tretë, e lidhur me të dytën “Biznesi i vogël dhe familja produktive” është një koordinim i fushave të mbulimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, e cila shihet e lidhur ngushtë në përmbushjen e disa funksioneve të saj bashkë me Ministrinë e Kulturës, si dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Objektiva që mbulon kjo shtyllë e programit janë edhe “Zhvillimi bujqësisë dhe fshatit”, si dhe “Biznesit të manifakturës, teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve”, që duket se një pjesë e mbulon edhe Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes. Në këtë shtyllë përfshihen edhe detyrat e infrastrukturës, energjisë, si pjesë mjaft të rëndësishme të premtimeve elektorale. Po këtu përfshihen edhe detyrat që mbulon turizmi dhe mjedisi, të pasur edhe nga Kultura.

Shtylla e katërt përgjithësisht kryesohet nga “Shoqëria digjitale”, që duket se mbulohet nga Ministri i Shtetit për Standarte dhe Shërbimet, si dhe AKSHI në koordinim mes tyre. Ndërsa, strehimi është një tjetër fushë mbulimi që është pjesë e koordinimit midis pushtetit qendror dhe bashkive, si pjesë e zbatimit të ligjit “Për strehimin social”.

Në paraqitjen e detyrave që i përgjigjen fushave të mbulimit sektorial, sipas Ministrive të Kabinetit Rama 3, shikohet se ka një mosvijmësi midis detyrave për rindërtimin dhe pandeminë që konsiderohen si prioritetet kryesore në Program, me mosegzistencën më të ministrit përgjegjës në ish - Kabinetin Rama 2. Me sa duket, pas vaksinimit situata është llogaritur drejt normalizimit duke mos e konsideruar më funksionale një ministri vetëm për këtë fushë mbulimi. Në po këtë shtyllë është vendosur edhe detyrat që mbulohen nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, lidhur me kategorinë që deri më sot nuk ka patur asnjë ministri që të ketë patur këtë emërtim brenda funksioneve të saj. Megjithatë, kjo ministri pa portofol ka detyra koordinuese me ministrinë e tjera që kanë fushë mbulimi direkt arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën, artin, kulturën, sportin, si dhe në koordinim me pushtetin vendor për ndërlidhjen e projekteve dhe politikave mes dy niveleve të qeverisjes në vend.

“Kujdesi për më të moshuarit dhe qytetarët në nevojë” është një tjetër nga fushat e mbulimit kryesisht nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale, por që ne e kemi vendosur vetëm njëherë në fillim të mbulimit të programit qeverisës për pandeminë. Në këtë rast flitet për gjysmën tjetër të funksioneve të saj, ato të mirëqenies sociale që lidhen me politikën e riintegritimit në vend të ndihmës ekonomike, pensionet dhe problemet e sigurimeve shoqërore dhe garantimit të skemës. Por, këtu është përfshirë edhe njëherë tjetër shëndetësia falas.

Shtylla e pestë, e cila dillon me “Shqipëria e së drejtës” përfshin detyra që mbulohen nga Ministria e Drejtësisë, ku veçohet reforma në drejtësi. “Siguria e pronës” është një tjetër fushë mbulimi e kësaj ministrie, si pjesë e shtyllës së pestë të programit. “Konsolidimi i imazhit dhe rolit të Shqipërisë” dhe “Mbrojtja e interesit të Shqiptarëve” janë të lidhur ngushtë me Ministrinë për Punët e Jashtme dhe Europën. “Forcimi dhe faktorizimi sa më shumë të jetë e mundur i pozicionit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare” është një nga detyrat e veçanta që i është vendosur ministrisë në kontekstin e programit qeverisës. Po në këtë pjesë është edhe siguria e vendit dhe mbrojtja në kuadër të anëtarësimit në NATO.

Integrimi Europian, ka si detyrë kryesore vizionin e Shqipërisë, si një proces i pandryshueshëm, por edhe Ballkanin e Hapur, si një nismë e re rajonale në kuadër të “Procesit të Berlinit”. “Shqipëria e sigurtë” është ndër detyrat që renditen në fund të prioriteteve të programit dhe mbulohen nga Ministria e Rendit.

Ndërkohë, në procesin e vendimmarrjes dhe hartimin e programeve nuk përfshihen shumë aktorë nga grupe të ndryshme sociale dhe grupe interesi. Publikut të gjerë i jepet për të dialoguar me përfaqësuesit e qeverisë politika/masa të diktuar nga qeveria, pa konsultime të thelluara. Nisur nga kjo qasje është ndikuar pjesërisht edhe performanca e realizimit të programeve qeverisëse. Analiza na tregon, se detyrat

e qeverisë nuk kanë shkuar më mirë, pasi kjo përvoje në realitet arrin të krijojë dublim dhe kosto të dëmshme financiare dhe etike.

Në përgjithësi, programet e mirëqenies dhe infrastrukturës kanë tërheqje shumë më të madhe buxhetore sesa programet e tjera dhe këtë e kemi vërejtur në të gjitha qeveritë e kaluara dhe programin e qeverisë Rama 3. Arsyeja kryesore është se ato përfshijnë përfitime politike të prekshme pasi shpenzimet në projekte të përqëndruara kanë shanse të kenë edhe suksesin e garantuar për të krijuar kapital politik. Kjo mënyrë, që vihet re veçanërisht, kur mandatet përsëriten. Programet në qeverisjet në vijimësi prodhojnë grupe të fuqishme interesi për të mbrojtur dhe zgjeruar përfitimet politike, por edhe orientimin e votuesit klientelist. Për më tepër, qeveritë kanë gjetur se zgjidhja e disa problemeve që adresohen për shtresat në nevojë dhe ato të marginalizuara mund të shmangë nevojën për një numër të madh ankesash nga votuesit.

Nga angazhimet më të mëdha financiare që Socialistët kanë marrë gjatë fushatës zgjedhore janë fatura e rindërtimit të dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i Nëntorit 2019, faturat e infrastrukturës, si dhe rritja e pagave për mësuesit, mjekët dhe infermierët të cilat minimalisht e rritin presionin fiskal ndaj buxhetit të shtetit me të paktën 2% të PBB-së. Të tre këto grup shpenzimesh përbëjnë 80.9% të totalit të shpenzimeve shtesë, si pasojë e aktivizimit të programit qeverisës Rama 3, në mbajtje të premtimeve të fushatës zgjedhore gjatë fillimvitit 2021.

Ndikimi i buxhetit nga programi qeverisës Rama 3, bazuar te premtimet zgjedhore në tërësinë e tij, i shton shpenzimeve të buxhetit një faturë vjetore prej 65.7 miliardë lekë dhe me një efekt në të hyrat e buxhetit me 4.8 miliardë lekë. Nisur nga llogaritja midis tyre, ndikimi në buxhet është me efekt negativ prej 60.9 miliardë lekësh.

Në tërësinë e programit të qeverisë Rama 2, në lidhje me shpenzimet shtesë sipas premtimeve elektorale, llogaritet një kosto buxhetore që ka ndikuar në një barrë në buxhetin e shtetit vit për vit sa 0.8% të PBB-së. Ndikimin më të madh në këtë rritje të koston buxhetore e kanë patur shpenzimet për infrastrukturën rrugore, shpenzimet për projektet për edukimin, për pagat e administratës dhe pensionet, shpenzimet për ujësjellës-kanalizimet dhe infrastrukturën e mbetjeve me një ndikim të borxhi sa 0.6% e PBB-së.

Detaje më të hollësishme jepen në Pjesën 3.

Në kushtet, kur treguesi mesatar i rritjes ekonomike në 4 vitet e fundit (pa përfshirë 2020) është 3.3%, atëherë objektivi prej 4.5% për periudhën 2021 -2025 është i arritshëm nëse do të plotësohen gjithë premtimet për investimet në infrastrukturën aeroportuale, infrastrukturën rrugore, turistike dhe investimet në sektorët e dedikuar të ekonomisë. Ky target është i besueshëm, nëse reformat e stopuara, si dhe reforma të nisura në qeverinë Rama 2 do të fillojnë të jetësohen që në vitin e parë të qeverisë, duke patur një plan veprimi të plotë dhe të qartë bashkë me buxhetin e bazuar te vlera e drejtë.

Nga efekti pozitiv i investimeve varet edhe një pjesë e performancës fiskale të të ardhurave tatimore, të cilat janë premtuar që si efekt i fiskalizimit do të synohen të arrijnë deri në fund të vitit 2025 sa 30% e PBB. Aktualisht, të ardhurat tatimore janë sa 25% e PBB-së. Pra një rritje me 5 pikë përqind do të thotë një rritje e tyre mesatare prej 20 miliard lekë në vit. Një e ardhur tatimore në këto vlera absolute kërkon të paktën, një rritje ekonomike me të paktën edhe 3% deri 4% më të lartë nga niveli aktual prej 2.2%.

Nisur nga nevoja për të reflektuar vit pas viti në Programin Qeverisës 2021 – 2025, ne mendojmë se:

- Qeveria Rama 3 duhet të angazhohet zyrtarisht në një risistemim të nevojshëm të skemës funksionale të pensioneve, pavarësisht indeksimit dhe zbatimit të bonueseve me efekt sa 5% rritje pensionesh.
- Qeveria duhet të shpallë zyrtarisht minimumin jetik, si dhe pasi është mjaft i nevojshëm të krijojë simbiozën me programin për riformatimin e ndihmës ekonomike. Ndërkohë, qeveria e ka përdorur llogaritjen e minimumit jetik për të ndryshuar pagën minimale, e cila në fakt nuk reflekton thjesht zhvillimin ekonomik dhe hapësirën fiskale, por është edhe një rritje e detyruar e tij, në varësi të ndryshimit të minimumit jetik.
- Agjencitë e qeverisë duhet zhvillojnë vlerësime për qëllime të ndryshme në një proces të ngjashëm/paralel me buxhetin: Zbatimi i buxhetit; Vlerësimet e kostove (vlerësimet e efekteve të premtimeve mbi shpenzimet, të ardhurat dhe deficitin); Parashikimet e shpenzimeve dhe deficitit sipas ligjit aktual; dhe Parashikimet e borxhit sipas ligjit aktual.

Në një analizë të programeve qeverisëse të periudhës 2009-2021 ne kemi analizuar edhe strukturat e kabineteve, për të dhënë një paraqitje më të plotë të qëllimit të analizës për përgjegjshmërinë financiare dhe besueshmërinë e programeve qeverisëse. Ne konstatojmë, se aleancat qeverisëse diktojnë edhe kompozimin e kabineteve qeverisëse (integrimi, mjedisi, shanset e barabarta). Disa funksione, si: rinia, sporti etj. na tregojnë se ndryshimi i fushës së mbulimit në vendimet e KM nuk ka argumentime specifike, por gjithsesi lëvizja nga një ministri te tjetra krijon probleme në lidhje me fokusin, si dhe ndjekjen konsistente të politikave, përtej synimit për përmirësim të politikës dhe vëmendjes së shtuar, që në fakt në Program përfaqësohen me një vëmendje rutinore.

Nëse shqyrtojmë kompozimin e qeverisë Rama 2 dhe Rama 3 dhe e krahasojmë me qeverinë Berisha 2, vërejmë të përbashkët konsolidimin e protokolleve të rëndësishme dhe me peshë për arritjen e centralizuar të suksesit për programet në krijimin e ministrive me funksione sa më të zgjeruara në raport me kabinetin paraardhës, të drejtuar nga i njëjti Kryeministër. Edhe në këtë rast, qeveria Rama 2 duket se ka synuar të njëjtën gjë.

Në mbyllje, duket se sfidat e pazgjidhura nga qeveria Rama 2 kanë nevojë të akomodohen në detyrat e reja të ministrive, që filluan nga puna në Shtator 2021. Në këtë kontekst, si një obligim parësor nevojitet që secila qeveri të bëjë edhe analiza fiskale transparente dhe analiza mbi kosto-përfitimin e politikave dhe ligjeve mjaft të rëndësishme për ekonominë dhe jetën e vendit, si p.sh. ligji mbi investimet strategjike në 2015, i cili zbatohet ngushtësisht i lidhur me akte të tjerë ligjore për thithjen e investimeve të huaja, zonat ekonomike dhe zhvillimin e strategjive kombëtare për sektorët më kryesorë.

MAJ/ MAY 2023



6000

DITËT E PARA TË QEVERISË "RAMA 3"

NIVELI I PËRMBUSHJES SË PIKAVE TË PROGRAMIT QEVERISËS
DHE PËRFSHIRJA E PREMTIMEVE ZGJEDHORE NË PROGRAM